



safejournalists.net

Maqedonia e Veriut – Treguesit për shkallën e lirisë së mediave dhe Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve 2023

Autor
Milan Spirovski



PËRMBAJTJA

Rreth Projektit

Zhvillimi i treguesve

Shënim metodologjik

Treguesit cilësorë të shkallës së lirisë së medias dhe të sigurisë së gazetarëve

Indeksi i sigurisë së gazetarëve

Lista e shkurtesave

I Hyrje

II Liria e mediave dhe siguria e gazetarëve në Maqedoninë e Veriut – Treguesit

A. Garancitë ligjore dhe zbatimi i tyre në praktikë

A.1 Garancitë themelore për lirinë e mediave dhe zbatimi i tyre në praktikë

A.2 Pavarësia dhe efikasiteti i organit rregullator

A.3 Pavarësia dhe autonomia e servisit publik mediatik

A.4 Mbështetje financiare për gazetari cilësorë dhe përmbajtje mediatike me interes publik

A.5 Reklamimi shtetëror në sektorin e medias private

A.6 Dispozitat ligjore në lidhje me publikimin dhe zbatimin nuk krijojnë efekte frikësuese për gazetarët dhe median.

A.7 Ligjet tjera zbatohen në mënyrë objektive dhe ju mundësojnë gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave të punojnë lirshëm dhe të sigurt

A.8 Besueshmëria e burimeve të gazetarëve është e garantuar në legjislacion dhe respektohet nga autoritetet

A.9 Gazetarët janë të lirë të ushtrojnë profesionin e tyre dhe të themelojnë, të bashkohen apo të marrin pjesë në shoqatat e tyre

A.10 E drejta e qasjes në dokumente dhe informacione zyrtare

B. Pozicioni i gazetarëve në redaksi

B.1 Pozita e gazetarëve në vendin e punës është e qëndrueshme dhe e mbrojtur

B.2 Pavarësia redaktoriale në mediat private

B.3 Pavarësia redaktoriale në radiodifuzerin publik

B.4 Pavarësia redaktoriale në sektorin jofitimprurës

B.5 Liria e gazetarëve në procesin e prodhimit të lajmeve

B.6 Pozita ekonomike e gazetarëve femra

C. Siguria e gazetarëve

C.1 Gazetarët dhe aktorët e tjerë mediatik kanë qasje në masat e shpejta dhe efektive mbrojtëse kur ekspozohen ndaj kërcënimeve

C.2 Gazetarët dhe aktorët e tjerë mediatik (jeta ose integriteti fizik i të cilëve është realisht në rrezik të drejtpërdrejtë) kanë qasje në mekanizma të veçantë për mbrojtje/siguri

C.3 Gazetarët femra kanë qasje në masat ligjore dhe mekanizmat mbështetëse kur përballen me kërcënime, ngacmime dhe dhunë me bazë gjinore

C.4 Është vendosur praktikë e dënimit të rregullt publik të rasteve të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe mediave

C.5 Zyrtarët policor janë të ndjeshëm në çështjen e mbrojtjes së gazetarëve

C.6 Njësitë dhe/ose zyrtarët e specializuar hetimorë janë të pajisur me ekspertizën përkatëse për hetimin e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve

C.7 Hetimet për sulmet e rënda fizike ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë mediatik zhvillohen me efikasitet (në mënyrë të pavarur, rrënjësore dhe të shpejtë)

C.8 Gazetarët dhe aktorët e tjerë të mediave mbrohen në mënyrë efektive nga forma të ndryshme të ngacmimit në internet

C.9 Hetimet për të gjitha llojet e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve dhe aktorëve tjerë të mediave zhvillohen në mënyrë transparente

C.10 Nga organet shtetërore janë vendosur sistemet për grumbullimin e të dhënave statistikore cilësore për parandalimin e mosndëshkimit

C.11 Kërcënimet dhe ngacmimet që nuk kanë të bëjnë me sigurinë fizike

C.12 Kërcënimet ndaj jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve

C.13 Sulmet e realta

C.14 Kërcënimet dhe sulmet ndaj mediave dhe shoqatave të gazetarisë

III Konkluzë dhe rekomandime

IV Indeksi i sigurisë së gazetarëve në Maqedoninë e Veriut – 2023

Rreth Projektit

ZHVILLIMI I TREGUESVE

Shoqatat e gazetarëve nga vendet e Ballkanit Perëndimor, të mbështetur nga Komisioni Evropian¹, themeluan platformën Safejournalists.net për të monitoruar së bashku legjislacionin dhe praktikën e medias në vendet e tyre dhe për t'u angazhuar në përmirësimin e mjedisit ligjor dhe institucional në të cilin punojnë gazetarët dhe profesionistët e tjerë të medias. Çdo vit, bazuar në një metodologji të hartuar me kujdes², Partnerët e Safejournalists.net kryejnë kërkime avokuese që u ofrojnë shoqatave të gazetarëve të dhëna të besueshme dhe relevante të bazuara në prova mbi problemet dhe pengesat kryesore në zbatimin e standardeve të BE-së në fushën e lirisë dhe sigurisë së mediave dhe gazetarëve në Ballkanin Perëndimor. Rezultatet e hulumtimit u japin përmbajtje aktiviteteve të partnerëve, duke u dhënë atyre dëshmi dhe shembuj të rinj që përsosin dhe forcojnë pozicionet e tyre avokuese.

Mjeti i parë kërkimor cilësor – Treguesit mbi nivelin e lirisë së medias dhe sigurisë së gazetarëve, u zhvillua për herë të parë në vitin 2016 dhe u përshtat gradualisht me kalimin e viteve. Ai përbëhet nga tre grupe treguesish: (A) Mbrojtja ligjore, (B) Pozicioni i gazetarëve në redaksi dhe (C) Siguria e gazetarëve. Bazuar në këtë mjet monitorimi, janë publikuar gjithsej shtatë vlerësime, i fundit ishte për vitin 2022.

Mjeti i kërkimit sasior – Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve, u zhvillua në vitin 2020 dhe u testua në vitin 2021. Ai është krijuar për të „matur” ndryshimet në mjedis që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë

-
- 1 Në dhjetor 2022, Komisioni Evropian miratoi një cikël të ri projekti tre-vjeçar për platformën Safejournalists.net, i cili është një vazhdim i dy fazave të mëparshme: projekti Platforma Rajonale e Avokimit për Liritë e Medias dhe Sigurinë e Gazetarëve në Ballkanin Perëndimor (janar 2016 – dhjetor 2018) dhe Safejournalist .net (shkurt 2020 – mars 2023). Qëllimi kryesor i projektit është të forcojë rolin e shoqatave kombëtare të gazetarëve, anëtarë të Platformës Safejournalists.net, për t'u bërë aktorë të pavarur efektivë dhe të përgjegjshëm në avokimin dhe krijimin e politikave përkatëse mediatike në vendet e tyre: Shoqata e Pavarur e Gazetarëve të Serbisë, Asociacioni i Gazetarëve të Bosnjës dhe Hercegovinës, Shoqata e Gazetarëve Kroatë, Shoqata e Gazetarëve të Kosovës, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë dhe Sindikata e Mediave të Malit të Zi. Projekti financohet nga Programi i BE-së për mbështetjen e shoqërisë civile dhe mediave në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi për 2021–2023 (IPA III).
- 2 Hulumtimi për avokim është dizajnuar dhe koordinuar nga Snezhana Trpevska dhe Igor Micevski, hulumtues në Institutin për Hulumtime të Zhvillimit Social RESIS nga Maqedonia e Veriut – www.resis.mk.

ose të tërthortë në atë se sa të sigurt ndihen gazetarët dhe aktorët e tjerë të medias kur ushtrojnë profesionin e tyre. Ai përbëhet nga katër grupe treguesish: (1) Mjedisi ligjor dhe organizativ, (2) Parandalimi, (3) Procesi dhe (4) Siguria faktike. Bazuar në këtë mjet, janë realizuar gjithsej tre cikle kërkimore: 2020 (viti pilot), 2021 dhe 2022.

Duke filluar nga viti 2023, Safejournalists.net do t'i kombinojë të dyja mjetet kërkimore (cilësore dhe sasore) në një projekt të vetëm kërkimor avokues – Treguesit e Nivelit të Lirisë së Medias dhe Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve. Platforma monitoron situatën në shtatë vende: Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, Maqedoni të Veriut, Mal të Zi, Kosovë³ dhe Serbi.

SHËNIM METODOLOGJIK

I gjithë procesi i kërkimit është i ndarë në dy faza: në fazën e parë mbledhen të dhënat për të gjithë treguesit cilësorë – si për liritë e medias ashtu edhe për sigurinë e gazetarëve, ndërsa në fazën e dytë konvertohen treguesit cilësorë për sigurinë e gazetarëve në ato sasore dhe kryhet procedura e pikëzimit dhe llogaritjes së Indeksit të Sigurisë së Gazetarëve.

Një sërë metodash të ndryshme kërkimi u aplikuan për të mbledhur dhe analizuar të dhënat në lidhje me secilin tregues cilësor:

- Rishikimi i studimeve, analizave, raporteve kërkimore, dokumenteve të politikave, strategjive dhe dokumenteve të tjera;
- Analiza cilësore e dokumenteve ligjore;
- Kërkimi dhe analiza e informacionit të publikuar në faqet e internetit të institucioneve publike dhe organizatave dhe organeve të tjera;
- Kërkimi dhe analiza e njoftimeve në media, njoftimeve dhe informacioneve të tjera të prodhuara nga organizata profesionale;
- Të dhënat dytësore të mbledhura nga shoqatat e gazetarëve;
- Intervistat e thelluara me ekspertë, gazetarë, politikëbërës, etj.;
- Fokus grupe me gazetarë
- Anketa me gazetarë (në disa nga vendet).

Në nivel kombëtar, kërkimi i avokimit kryhet nga studiues kombëtarë, të cilët mbledhin të dhënat dhe përgatisin raporte narrative, të cilat më pas shqyrtohen nga mediat lokale dhe

3 Ky emër është pa paragjykim për statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe me mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Deklaratën dhe Pavarësinë e Kosovës.

ekspertët ligjorë dhe hulumtuesi kryesor. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) emëroi Millan Spirovskin si studiues kombëtar.

TREGUESIT CILËSORË TË SHKALLËS SË LIRISË SË MEDIAS DHE TË SIGURISË SË GAZETARËVE

Tabela e mëposhtme paraqet të gjithë treguesit cilësorë për nivelin e lirisë së medias dhe sigurisë së gazetarëve, të ndarë në tre fusha. Këta tregues cilësorë paraqiten në formë përshkruese ose narrative. Treguesit e përdorur në kuadrin konceptual për Indeksin e Sigurisë së Gazetarëve janë theksuar me ngjyrë hiri në tabelë.

Pasqyrë e të gjithë treguesve cilësorë (Treguesit për nivelin e lirisë së medias dhe sigurisë së gazetarëve)

A. Garancitë ligjore dhe zbatimi i tyre në praktikë	B. Pozita e gazetarëve në redaksi	C. Siguria e gazetarëve
A.1 Garancitë themelore për lirinë e mediave dhe zbatimi i tyre në praktikë	B.1 Pozita e gazetarëve në vendin e punës është e qëndrueshme dhe e mbrojtur	C.1 Gazetarët dhe aktorët tjerë mediatik kanë qasje në masat e shpejta dhe efektive mbrojtëse kur ekspozohen ndaj kërcënimeve
A.2 Pavarësia dhe efikasiteti i organit rregullator	B.2 Pavarësia redaktoriale në mediat private	C.2 Gazetarët dhe aktorët e tjerë të mediave (jeta ose integriteti fizik i të cilëve është realisht në rrezik të drejtpërdrejtë) kanë qasje në mekanizma të veçantë për mbrojtje/siguri
A.3 Pavarësia dhe autonomia e servisit publik mediatik	B.3 Pavarësia redaktoriale në radiodifuzerin publik	C.3 Gazetarët kanë qasje në masat ligjore dhe mekanizmat mbështetëse kur përballen me kërcënime, ngacmime dhe dhunë me bazë gjinore
A.4 Mbështetje financiare për gazetari cilësorë dhe përmbajtje mediatike me interes publik	B.4 Pavarësia redaktoriale në sektorin jofitimprurës	C.4 Është vendosur praktikë e dënimit të rregullt publik të rasteve të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe mediave
A.5 Reklamimi shtetëror në sektorin e medias private	B.5 Liria e gazetarëve në procesin e prodhimit të lajmeve	C.5 Zyrtarët policor janë të ndjeshëm në çështjen e mbrojtjes së gazetarëve
A.6 Dispozitat ligjore në lidhje me shpifjen dhe zbatimi i tyre nuk krijojnë efekte frikësuese ndaj gazetarëve dhe mediave	B.6 Pozita ekonomike e gazetarëve (femra)	C.6 Njësitë dhe/ose zyrtarët e specializuar hetimorë janë të pajisur me ekspertizën përkatëse për hetimin e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve
A.7 Ligjet tjera zbatohen në mënyrë objektive dhe ju mundësojnë gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave të punojnë lirshëm dhe të sigurt		C.7 Hetimet për sulmet e rënda fizike ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë mediatik zhvillohen me efikasitet (në mënyrë të pavarur, rrënjësore dhe të shpejtë)
A.8 Besueshmëria e burimeve të gazetarëve është e garantuar në legjislacion dhe respektohet nga autoritetet		C.8 Gazetarët dhe aktorët e tjerë të mediave mbrohen në mënyrë efektive nga forma të ndryshme të ngacmimit në internet
A.9 Gazetarët janë të lirë të ushtrojnë profesionin e tyre dhe të themelojnë, të bashkohen apo të marrin pjesë në shoqatat e tyre		C.9 Hetimet për të gjitha llojet e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve dhe aktorëve tjerë të mediave zhvillohen në mënyrë transparente
A.10 E drejta e qasjes në dokumente dhe informacione zyrtare		C.10 Nga organet shtetërore janë vendosur sistemet për grumbullimin e të dhënave statistikore cilësore për parandalimin e mosndëshkimit
		C.11 Kërcënimet dhe ngacmimet që nuk kanë të bëjnë me sigurinë fizike

A. Garancitë ligjore dhe zbatimi i tyre në praktikë	B. Pozita e gazetarëve në redaksi	C. Siguria e gazetarëve
		C.12 Kërcënimet ndaj jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve
		C.13 Sulmet reale
		C.14 Kërcënime dhe sulme ndaj mediave dhe shoqatave gazetareske

INDEKSI I SIGURISË SË GAZETARËVE

Duke marrë parasysh standardet dhe rekomandimet e vendosura nga Këshilli i Evropës dhe organizata të tjera ndërkombëtare, koncepti i „sigurisë së gazetarëve”⁴ u funksionalizua duke mbajtur parasysh katër dimensionet e mëposhtme:

- I. **Mjedisi ligjor dhe organizativ** – ekzistenca dhe zbatimi i masave ligjore mbrojtëse që kanë të bëjnë me sigurinë e gazetarëve.
- II. **Parandalimi** – ekzistenca dhe zbatimi i një sërë masash parandaluese që kanë efekt të drejtpërdrejtë në mbrojtjen dhe sigurinë e gazetarëve.
- III. **Procesi** – sjellja e institucioneve shtetërore dhe zyrtarëve publikë ndaj gazetarëve dhe efektiviteti i sistemit të drejtësisë penale dhe civile në lidhje me hetimet e kërcënimeve dhe akteve të dhunës ndaj gazetarëve.
- IV. **Siguria faktike** – incidente dhe raste të formave të ndryshme të kërcënimeve dhe akteve të dhunës ndaj gazetarëve dhe mediave.

Tabela e mëposhtme paraqet katër dimensionet dhe treguesit që përbëjnë modelin teorik të konceptit „siguria e gazetarëve”. Të dhënat për të gjithë këta tregues u mbledhën në fazën e parë të sondazhit, ndërsa në fazën e dytë bazuar në dëshmitë e mbledhura të anketës me nëntë anëtarë të Panelit Këshillimor⁵ nga secili vend që vlerësuan situatën dhe caktuan pikë për secilin nga 19 treguesit:

Pasqyrë e treguesve që lidhen me Indeksën e Sigurisë së Gazetarëve

I. Mjedisi ligjor dhe organizativ	II. Parandalimi	III. Procesi	IV. Siguriareale
1.1 Dispozitat ligjore në lidhje me shpifjen dhe zbatimi i tyre nuk krijojnë efekte frikësuese ndaj gazetarëve dhe mediume	2.1 Gazetarët dhe aktorët tjerë mediatik kanë qasje në masat e shpejta dhe efektive mbrojtëse kur ekspozohen ndaj kërcënimeve	3.1 Njësitë dhe/ose zyrtarët e specializuar hetimorë janë të pajisur me ekspertizën përkatëse për hetimin e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve	4.1 Kërcënimet dhe ngacmimet që nuk kanë të bëjnë me sigurinë fizike

4 Studiuesit e Institutit RESIS (www.resis.mk), Snezhana Trpevska, Igor Micevski dhe Ljubinka Popovska Tosheva zhvilluan kornizën konceptuale dhe metodologjike për Indeksën dhe modelin e vlerësimit, peshimit dhe llogaritjes së tij.

5 Anëtarë të Panelit Këshillimor në Maqedoninë e Veriut ishin: Goce Trpkovski, Aleksandra Temenugova, Frosina Fakova-Serafimoviç, Sonja Petrushevska Popovska, German Fillkov, Riad Murati, Semra Musai, Martin Pushevski dhe Teofill Bllazhevski.

I. Mjedisi ligjor dhe organizativ	II. Parandalimi	III. Procesi	IV. Siguriareale
1.2 Besueshmëria e burimeve të gazetareve është e garantuar në legjislacion dhe respektohet nga autoritetet	2.2 Gazetarët dhe aktorët e tjerë të mediave (jeta ose integriteti fizik i të cilëve është realisht në rrezik të drejtpërdrejtë) kanë qasje në mekanizma të veçantë për mbrojtje/siguri	3.2 Hetimet për sulmet e rënda fizike ndaj gazetareve dhe aktorëve të tjerë mediatik zhvillohen me efikasitet (në mënyrë të pavarur, rrënjësore dhe të shpejtë)	4.2 Kërcënimet ndaj jetës dhe sigurisë fizike të gazetareve
1.3 Ligjet tjera zbatohen në mënyrë objektive dhe ju mundësojnë gazetareve dhe aktorëve të tjerë të mediave të punojnë lirshëm dhe të sigurt	2.3 Gazetarët kanë qasje në masat ligjore dhe mekanizmat mbështetëse kur përballen me kërcënime, ngacmime dhe dhunë me bazë gjinore	3.3 Gazetarët dhe aktorët e tjerë të mediave mbrohen në mënyrë efektive nga forma të ndryshme të ngacmimit në internet	4.3 Sulmet e realta
1.4 Gazetarët janë të lirë të ushtrojnë profesionin e tyre dhe të themelojnë, të bashkohen apo të marrin pjesë në shoqatat e tyre	2.4 Është vendosur praktikë e dënimit të rregullt publik të rasteve të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetareve dhe mediave	3.4 Hetimet për të gjitha llojet e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetareve dhe aktorëve tjerë të mediave zhvillohen në mënyrë transparente	4.4 Kërcënimet dhe sulmet ndaj mediave dhe shoqatave të gazetarisë
1.5 Pozita e gazetareve në vendin e punës është e qëndrueshme dhe e mbrojtur	2.5 Zyrtarët policor janë të ndjeshëm në çështjen e mbrojtjes së gazetareve	3.5 Nga organet shtetërore janë vendosur sistemet për grumbullimin e të dhënave statistikore cilësore për parandalimin e mosndëshkimit	

Shënim: Kur përdoret forma e gjuhës mashkullore në këtë raport, ai gjithmonë u referohet njëkohësisht individëve të gjinisë femërore, mashkullore ose gjinisë tjetër. Etiketat e shumta nuk përdoren për lexueshmëri më të mirë të raportit.

— LISTA E SHKURTESAVE

KSHZ Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve

ASHMAAV Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive

RTM Radio – televizioni i Maqedonisë

SHGM Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë

MSHIA Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës

SPGPM Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik

IMM Instituti Maqedonas i Mediave

KEMM Këshilli për Etikë në Media të Maqedonisë

RMV Republika e Maqedonisë së Veriut

MIA (AIM) Agjencia Informative Mediatike

IRL(RGH) Laboratori i Gazetarëve Hulumtues



Hyrje

Informacion bazë për vendin: Republika e Maqedonisë së Veriut është një demokraci parlamentare, në të cilën pas çdo zgjedhje parlamentare, qeveria formohet nga partitë politike të bllokut maqedonas dhe shqiptarë që kanë fituar më shumë vota. Karakteri multietnik i shtetit shton një kompleksitet shtesë në dinamikën socio-politike që ndikon edhe në sferën mediatike. Sipas Regjistrimit të Popullsisë dhe Familjeve⁶ të kryer në vitin 2021, popullsia e përgjithshme rezidente e RMV është 1.836.713 banorë, ku sipas deklaramit të përkatësisë etnike: 58.44% janë maqedonas, 24.30% janë shqiptarë, 3.86% janë turq, 2.53% janë romë, 0.47% janë vlllehë, 1.30% janë serbë, 0.87% janë boshnjakë dhe një përqindje më e vogël janë pjesëtarë të bashkësive të tjera etnike. Sipas përkatësisë fetare, 46.14% janë ortodoksë, 32.17% janë myslimanë (islam), 0.37% janë katolikë dhe një përqindje më e vogël e deklarojnë veten si agnostikë ose anëtarë të grupeve dhe komuniteteve të tjera fetare.

Konteksti politik: Vendi vazhdon të përballlet me sfida në zhvillimin e tij demokratik dhe integrimet euroatlantike. Në vitin 2023, qeveria e koalicionit të LSDM-së dhe BDI-së, e cila fitoi më së shumti vota në zgjedhjet e parakohshme parlamentare dy vjet më parë, ishte në pushtet. Tensionet lidhur me çështjet kryesore kombëtare, duke përfshirë integrimin evropian dhe marrëdhëniet dypalëshe me vendet fqinje, kanë krijuar një atmosferë jostabiliteti politik. Kjo situatë pati një ndikim të drejtpërdrejtë edhe në media, me akuza të shpeshta për ndikim politik në politikat editoriale dhe raportime selektive Si kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian, vendi është nën monitorim të vazhdueshëm në lidhje me sundimin e ligjit, lirinë e medias dhe të drejtat e njeriut.

Situata ekonomike: Pamja ekonomike në vitin 2023 ishte komplekse, duke reflektuar sfidat globale dhe tendencat ekonomike lokale. Inflacioni dhe kriza energjetike patën një ndikim të rëndësishëm në situatën e

6 Enti Shtetëror i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut. [Regjistrimi i popullsisë në vitin 2021](#).

përgjithshme ekonomike, e cila indirekt ndikoi edhe në sektorin e medias. Shumë media janë përballur me vështirësi financiare, duke çuar në përkeqësim të mëtejshëm të statusit socio-ekonomik të gazetarëve dhe ulje të buxheteve për gazetarinë investigative dhe raportim cilësor. Tregu i reklamave mbeti i kufizuar, me një pjesë të konsiderueshme të reklamave që synonin platformat dixhitale, duke ulur më tej të ardhurat nga mediat tradicionale. Kjo pasiguri ekonomike ka krijuar një terren për rritjen e varësisë së medias nga interesat politike dhe të biznesit, duke rrezikuar potencialisht pavarësinë e tyre editoriale.

Mjedisi rregullator: Gjatë vitit 2023, Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës (MSHIA) ka iniciuar një sërë reformash mediatike me qëllim ndryshimin e kuadrit ligjor për median dhe përafrimin e tij me standardet evropiane. Nisma u mbështet nga asistenca teknike nga ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë në kuadër të një projekti të financuar nga Komisioni Evropian. Qëllimi i këtyre përpjekjeve ishte harmonizimi i ligjeve të medias me direktivat e BE-së, rekomandimet e Këshillit të Evropës dhe standardet e tjera ndërkombëtare. Gjatë konsultimeve publike të organizuara në kuadër të këtij procesi, televizionet private në nivel shtetëror kanë ushtruar presion të fortë për rikthimin e reklamave shtetërore në mediat audiovizive, pavarësisht paralajmërimeve të shoqatave gazetareske dhe ekspertëve se kjo praktikë në të kaluarën kërcënonte seriozisht pavarësinë editoriale të medias dhe trazoi kushtet e tregut mediatik.



Liria e mediave dhe siguria e gazetarëve në Maqedoninë e Veriut – Treguesit

A. GARANCITË LIGJORE DHE ZBATIMI I TYRE NË PRAKTIKË

— A.1 GARANCITË THEMELORE PËR LIRINË E MEDIAVE DHE ZBATIMI I TYRE NË PRAKTIKË

Garancitë themelore për lirinë e shprehjes dhe pavarësinë e mediave, përveç Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, janë të inkuorporuara në media dhe në disa ligje të tjera⁷. Të gjitha këto ligje përfshijnë të drejtën e qasjes në internet, domethënë nuk ka një rregullore të veçantë që rregullon vetëm internetin. Garancitë kushtetuese të përcaktuara në nenin 16 të Kushtetutës, për lirinë e shprehjes dhe qasjen e lirë në informacion, vlejnë edhe për komunikimin nëpërmjet internetit.

E drejta e lirisë së shprehjes, duke përfshirë edhe hapësirën e internetit, ushtrohet lirisht nga qytetarët, gazetarët, mediat dhe organizatat e tjera. Në vitin 2023, nuk ka pasur asnjë rast të vetëm të regjistruar ose të dokumentuar të qeverisë ose autoriteteve të tjera shtetërore që tentojnë të zbatojnë bllokimin ose filtrimin e përmbajtjes së internetit. Konfirmim i këtyre vlerësimeve është edhe fakti se në vitin 2023 vendi shënoi rritje në shkallën e Indeksit të Reporterëve pa Kufij⁸ nga gjithsej 180 vende ajo u rendit në vendin e 38-të, që është 19 vende më lart se në 2022. Raporti thekson gjithashtu se mjedisi i përgjithshëm mbetet i favorshëm për lirinë e medias dhe lejon raportim kritik, megjithëse transparenca e institucioneve është mjaft e dobët. Vazhdon tendenca që zyrtarët e qeverisë të kenë qëndrime negative dhe ofenduese ndaj gazetarëve.

Në janar 2023, Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës (MSHIA) shpalli një proces transparent dhe gjithëpërfshirës të reformës

7 Këto garanci janë të inkuorporuara në Ligjin për Media, Ligjin për Shërbimet Mediale Audio dhe Audiovizive, Ligjin për Qasje të Lirë në Informatat Publike, Ligjin për Përgjegjësinë Civile për Shpifje dhe akte të tjera ligjore.

8 [Indeksi vjetor i Reporterëve Pa Kufij – Republika e Maqedonisë së Veriut 2023.](#)

së medias⁹. Procesi u nda në dy faza: (1) deri në maj për të sjellë legjislacionin vendas në përputhje me Direktivën e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizive të vitit 2018, (2) deri në Dhjetor për të hartuar ligje të reja që do të vendosnin bazat për zgjidhjen e problemeve strukture në sferën mediatike¹⁰. Në fazën e parë, procesi ishte transparent, me pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve, përfshirë shoqatat e gazetarëve. Por në fazën e dytë, MSHIA organizoi një debat publik vetëm për zgjidhjet e pjesshme, të bëra nga televizionet kryesore private, të cilat propozuan heqjen e ndalimit të reklamave shtetërore në mediat elektronike. Këtë propozim e kundërshtuan shoqatat dhe organizatat e gazetarëve dhe mediave¹¹, duke paralajmëruar se rifutja e reklamave shtetërore mbart një rrezik serioz për pavarësinë e medias dhe lirinë e gazetarëve. Por, në nëntor të vitit 2023, Qeveria e ka dorëzuar këtë propozim-ligj për miratim në Kuvend.

Nuk ka licenca apo kërkesa të tjera strikte për krijimin e një media të shkruar ose online në vend. Mediat e shkruara i nënshtrohen rregullimit minimal me dispozitat e Ligjit për Media, për sa i përket detyrimeve themelore për publikun në veprimtarinë e tyre, mbrojtjen e burimeve të informacionit, mbrojtjen e të miturve, ndalimin e gjuhës së urrejtjes dhe nxitjes së dhunës dhe disa detyrime të tjera lidhur me organizimin e brendshëm dhe aktet e nevojshme. Mediat online nuk mbulohen fare nga legjislacioni për median, pra përmbajtja e tyre i nënshtrohet vetërregullimit.

— A.2 PAVARËSIA DHE EFIKASITETI I ORGANIT RREGULLATOR

Në kuadër të funksionimit dhe aktiviteteve të organit rregullativ në vend – Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive (ASHMAAV), vërejtja kryesore mund t'i drejtohet sërish Kuvendit, i cili për shkak të mungesës së konsensusit politik ndërmjet partive më të mëdha, ende nuk ka bërë zgjedhjen e anëtarëve të përbërjes së re të Këshillit të ASHMAAV¹², ndonëse anëtarëve aktualë ka kohë që i ka skaduar mandati. Kjo tregon se përpjekjet për ndikim politik në punën e rregullatorit janë ende të pranishme.

Gjatë vitit të kaluar nuk është dokumentuar asnjë rast mbi bazën e të cilit ASHMAAV do të vlerësohej si organ jo i pavarur ose që nuk vepron në mënyrë të drejtë dhe jodiskriminuese ndaj mediave, veprimtaritë e të cilave ajo mbikëqyr. Në vitin 2023, bazuar në monitorimin e kryer, ASHMAAV ka lëshuar

9 Vitin e kaluar në Republikën e Maqedonisë së Veriut u implementua projekti „BE për lirinë e shprehjes: harmonizimi i legjislacionit kombëtar për media me ligjin e BE-së dhe standardet evropiane të medias”. Projekti u mbështet nga BE-ja dhe u zbatua nga një konsorcium organizatash këshilluese. Janë punësuar dy ekspertë vendas dhe dy të huaj. Aktivitetet kishin për qëllim harmonizimin me Direktivën për ASMAAV nga viti 2018 dhe me dokumentet e tjera të BE-së dhe rekomandimet e Këshillit të Evropës, si dhe zgjidhjen e një sërë problemesh sistematike që penguan zhvillimin e një sistemi mediatik pluralist që u shërben interesave të qytetarët.

10 Instituti RESIS, [“Drejt një sektori mediatik të qëndrueshëm, të larmishëm dhe të sigurt: Mbështetja e demokracisë dhe pluralizmit dhe shërbimi ndaj qytetarëve”](#). Përmbledhje e punëtorisë së mbajtur në kuadër të fazës së dytë të projektit „BE për lirinë e shprehjes: harmonizimi i legjislacionit kombëtar të medias me ligjin e BE-së dhe standardet evropiane të medias”. Shkup: 2023.

11 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, [“Liria e mediave në Maqedoninë e Veriut: Përparim në këmbë të gelqta”](#) Raport nga Misioni për vlerësimin e situatës me lirinë e mediave. Shkup: 2023.

12 [Komisioni Evropian – Raporti për përparim të RMV-së për vitin 2023](#). Bruksel: 2023

gjithsej 12 paralajmërime publike për 8 transmetues¹³. Një botuesi i medias së shkruar i është shqiptuar vërejtje për mospërbushje të obligimit për publikimin e të dhënave të përcaktuara në nenin 14 paragrafi 1 të Ligjit për Media.

Rregullatori ka vepruar në mënyrë të drejtë dhe neutrale gjatë dhënies së lejeve dhe zbatimit të akteve nënligjore përkatëse në fushën audiovizive. Megjithatë, me ndryshimet në nenin 79 të këtij ligji, të miratuar në shkurt të vitit 2024¹⁴ minohet pavarësia e organit rregullator, d.m.th i hiqet autoriteti për të vendosur për rinovimin e licencave bazuar në kontributin e transmetuesit në diversitetin e programit dhe pluralizmin mediatik në tërësi¹⁵.

— A.3 PAVARËSIA DHE AUTONOMIA E SERVISIT PUBLIK MEDIATIK

Autonomia dhe pavarësia e servisit publik mediatik janë pjesërisht të garantuara me LSHMAAV i cili përmban një dispozitë të përgjithshme që garanton pavarësinë e RTVM-së nga shteti ose nga personat dhe organet e tjera juridike, por formulimi i dispozitës është i paqartë. Ligji nuk përmban një dispozitë të qartë se redaksitë e RTVM-së janë të pavarura dhe autonome në krijimin e programit, megjithëse garanton pavarësinë e redaktorëve dhe gazetarëve, sipas nenit 61 (parimet e përgjithshme për të gjitha shërbimet mediatike audiovizive). Për më tepër, sipas nenit 104, gazetarët, redaktorët dhe punonjësit e tjerë të përfshirë në prodhimin e programeve nuk duhet të konsiderohen nëpunës publikë, që do të thotë se pyetjet për punësimin, punën dhe përparimin e tyre në karrierë nuk duhet t'i nënshtrohen dispozitave të Ligjit për sektorin e të punësuarve publikë. Në vitet e kaluara, RTVM-ja kërkoi miratim nga tri ministri (përfshirë Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës dhe Ministrinë e Financave) lidhur me këto çështje. Kjo krijoi një lloj presioni mbi punën e gazetarëve dhe redaktorëve të punësuar në RTVM dhe vinte në dyshim pavarësinë e tyre editoriale. Përveç dispozitave të përcaktuara në LSHMAAV dhe Ligjin për Ndërmarrjet Publike, për të arritur autonomi të plotë institucionale të RTM-së, është e nevojshme të bëhen ndryshime shtesë edhe në ligje të tjera¹⁶.

Për autonominë e servisit publik, çështja e financimit të qëndrueshëm dhe të pavarur të tij është kyçe. Me ndryshimet në nenin 105 të LSHMAAV-së të miratuara në korrik të vitit 2023, mjetet për funksionimin dhe zhvillimin e RTM-së

13 Nga këto masa, 3 janë shqiptuar për shkak të mos përbushjes së obligimeve për sigurimin e audiencës në punë, 2 për mospërbushje të obligimeve për transmetim të së paku 30% të programit të krijuar në gjuhën maqedonase dhe një vërejtje për shkak të theksimit të tepërt të produkteve të vendosura në program, përdorimit jo të duhur të gjuhës, mospërbushjes së detyrimit për të publikuar impresumin; mosrespektimi i rregullave për mbrojtjen e audiencave të vogla, transmetimi i reklamave të fshehura audiovizive; mosrespektimi i rregullave për transmetimin e komunikimeve komerciale audiovizive dhe mosparaqitja e raportit me shkrim për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në leje.

14 [Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale](#), (Gazeta Zyrtare e RMV Nr. 55/2024).

15 Jo vetëm që është fshirë nga neni 79 ky kriter, por është futur një dispozitë absurde, që nënkupton se transmetuesit mund të transmetojnë gjuhë të urretjes, të bëjnë thirrje për përmbysjen e rendit kushtetues, të kërcënojnë sigurinë kombëtare dhe të transmetojnë përmbajtje të dëmshme për zhvillimin e të miturve, përmbajtje të tjera të dëmshme, përkatësisht, sipas nenit të ri 79, rregullatori nuk mund të refuzojë vazhdimin e licencës, përveç nëse transmetuesi ka bërë shkelje të rënda dhe të paktën tre herë gjatë kohëzgjatjes së licencës nuk i ka respektuar ndalesat e veçanta të nenit 48 të këtij ligji, për të cilat ka vendime gjyqësore të vlefshme, ose – gjatë kohëzgjatjes së lejes, të paktën në një cikël zgjedhor, mbulimi mediatik nuk është bërë në mënyrë të drejtë, të balancuar dhe të paanshme, për të cilën ekzistojnë vendime të plotfuqishme në gjykata.

16 Të gjitha këto çështje janë elaboruar në mënyrë të detajuar në analizën e titulluar „Pasqyrë e kornizës ligjore të servisit publik transmetues TVM në aspektin e rolit, kompetencës, pavarësisë dhe financimit, nga këndvështrimi i ligjit të BE-së dhe standardeve dhe praktikës mediatike evropiane”. Kjo analizë është dorëzuar në Ministrinë kompetente të Shoqërisë Informatike dhe Administratës në fund të vitit 2023, nga ekipi i ekspertëve të angazhuar në projekt. „[BE për lirinë e shprehjes: harmonizimi i legjislacionit kombëtar të medias me ligjin e BE-së dhe standardet evropiane të medias](#)”.

sigurohen nga Buxheti, në masën 1% të të hyrave tatimore të realizuara të përcaktuara në llogarinë e fundit përfundimtare të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut¹⁷. Edhe pse këto ndryshime legjislative garantojnë financim më të qëndrueshëm të RTM-së, ka ende të meta potenciale. E meta e parë është se RTVM nuk ka një projeksion financiar shumëvjeçar në planin e saj strategjik¹⁸, kështu që investimet kapitale nuk planifikohen për më shumë se një vit. Së dyti, fonde shtesë për zhvillimin teknologjik mund të jenë ndarë ose jo nga Buxheti, duke lënë kështu hapësirë për ndikim arbitrar nga Qeveria. Së treti, mbetet rreziku që korniza e re të mos zbatohet, gjë që në fakt ndodhi: qeveria RMV-së nuk e zbatoi formulën e re të miratuar deri në fund të vitit 2023.

Situata nuk ka ndryshuar në lidhje me emërimin e anëtarëve të rinj të Këshillit Programor të RTM-së nga Kuvendi, për shkak të mungesës së konsensusit mes partive kryesore politike. Ligji parashikon që për këto emërime kërkohet një shumicë prej dy të tretash, por në kontekstin aktual politik nuk ka qenë e mundur të mbledhet një shumicë e tillë dhe zgjedhja e këtij organi kyç të RTM-së është bllokuar.

— A.4 MBËSHTETJE FINANCIARE PËR GAZETARI CILËSORE DHE PËRMBAJTJE MEDIATIKE ME INTERES PUBLIK

Në vitin 2023, Qeveria e RMV-së, për herë të pestë, miratoi një program për të mbështetur shtypjen dhe shpërndarjen e mediave të shkruara të një natyre të përgjithshme dhe informative¹⁹, në vlerë prej 10 milionë denarë, që është dukshëm më e ulët në krahasim me katër vitet e kaluara²⁰. Për ndarjen e mjeteve vendos një komision, i cili përveç përfaqësuesve të institucioneve kompetente përfshin edhe nga një përfaqësues të Shoqatës për Mbrojtjen e Mediave të Shkruara Kombëtare dhe të SHGM-së. Nga mjetet e planifikuara, 2 milionë denarë janë ndarë për mediat e shkruara në nivel lokal, ndërsa 8 milionë denarë për mediat e shkruara në nivel vendi. Vlerësimi i SHGM-së është se procesi i ndarjes së mjeteve ka qenë i drejtë, transparent dhe jodiskriminues.

Në vend nuk ekziston një Fond i Pluralizmit për të mbështetur prodhimin e përmbajtjeve mediatike me interes publik, por ka një iniciativë për futjen e një fondi të tillë. Në kuadër të projektit të reformës së medias, i mbështetur nga BE-ja në vitin 2023, është hartuar teksti i një Ligji të ri për Median, i cili përfshin edhe dispozita për Fondin e Pluralizmit të Përmbajtjes. Përpos këtij propozim ligji, SHGM-ja ka publikuar një raport në të cilin një pjesë e veçantë i është kushtuar fondit për pluralizëm të përmbajtjeve mediatike²¹. Gjithashtu në Raportin e Misionit për vlerësimin e situatës me lirinë e

17 Mjetet janë të ndara si më poshtë: 80% për TVM-në për mbulimin e shpenzimeve për krijimin dhe transmetimin e programeve dhe për zhvillimin tekniko-teknologjik, 15% për NP „Radiodifuzioni i Maqedonisë” për mirëmbajtjen, shfrytëzimin dhe zhvillimin e rrjetit të transmetimit publik dhe 5% për Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.
18 Radio Televizioni i Maqedonisë, „Strategjia pesëvjeçare për zhvillimin e RTVM-së”. Shkup: 2021.
19 Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, „Thirrje Publike 2023 për Mbështetjen e shpyrtjes dhe shpërndarjes së mediave të shkruara për vitin 2023”. Shkup: 2023.
20 Trpkovski, Goce. „Gazetat ditore kombëtare këtë vit janë përjashtuar nga subvencionet”. Prizma, 18 dhjetor 2023.
21 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, „Të drejtat e gazetarëve, liria e shprehjes dhe mediave në Maqedoninë e Veriut - Raporti metadata për vitin 2023”. Shkup: 2023.

mediave²², krahas një vështrimi krahasues, ofrohen edhe zgjidhje konkrete të zbatueshme në kontekstin kombëtar.

Përveç programeve radiotelevizive në gjuhët e bashkësive etnike, në kuadër të servisit të transmetimit publik, nuk ekzistojnë mekanizma të tjerë për financimin e mediave në gjuhët e bashkësive të ndryshme etnike. Mediat që publikojnë përmbajtje në gjuhët e komuniteteve joshumicë në RMV nuk janë tërheqëse për reklamuesit, kështu që ata kanë vite që përballen me vështirësi financiare për të mbijetuar në treg. Mungon një politikë adekuate mediatike për zgjidhjen e këtij problemi, e cila reflektohet në pasqyrën e përgjithshme pluraliste të sektorit mediatik në RMV.

— A.5 REKLAMIMI SHETETËROR NË SEKTORIN E MEDIAS PRIVATE

Me ndryshimin e pushtetit në vend, në vitin 2016, qeveria e LSDM-së vendosi për moratorium të plotë të reklamave shtetërore me kërkesë të SHGM-së dhe sektorit joqeveritar. Vitet e kaluar ky vendim është respektuar, por në nivel lokal, komunat dhe ndërmarrjet publike, megjithatë kanë ndarë mjete nga buxhetet e dedikuara për mediat private lokale, gjë që në thelb ka cenuar pozitën e tyre të pavarur. Në vitin 2023, presioni ndaj qeverisë u rrit nga transmetuesit kryesorë privatë për të hequr ndalimin e reklamave shtetërore. Në shkurt të vitit 2024, Kuvendi i RMV-së miratoi ndryshimet në Ligjin për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizive, me të cilat u hoq ndalimi i reklamave shtetërore në televizionet private²³. Është përcaktuar edhe shuma: „0,1 për qind e buxhetit të shtetit nga të ardhurat tatimore të përcaktuara në faturën përfundimtare të buxhetit”. Për vitin 2023, kjo shumë do të ishte 2.3 milionë euro. Nga fondet e siguruar, 40 për qind do të mund të përdoren nga televizionet kombëtare, 40 për qind nga televizionet kablllore dhe satelitore, 15 për qind nga televizionet rajonale dhe lokale dhe 5 për qind nga radiot. Si shteti ashtu edhe komunat do të kenë obligim të transmetojnë fushata.

Zgjidhja e re ligjore, që rikthen praktikën e reklamimit shtetëror në mediat private audiovizive, deri në publikimin e këtij raporti, nuk është zbatuar ende në praktikë dhe do të jetë ende objekt vëzhgimi. Shoqatat e gazetarëve dhe disa ekspertë në fushën e politikës mediatike ishin plotësisht kundër heqjes së ndalimit të reklamave shtetërore, sepse „krijon një mekanizëm financiar kompleks të daljes së 'legalizuar' të parave publike në të gjitha mediat private audiovizive, gjë që përfundimisht i vë në një pozicion të varësisë së drejtpërdrejtë nga autoritetet qendrore dhe lokale”²⁴. Për këtë zgjidhje ligjore ka reauar edhe Shoqata e Mediave Private Online, pasi përjashton mediat online plotësisht, me çka bëhet diskriminim sipas llojit të medias.

22 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, ["Liria e mediave në Maqedoninë e Veriut: Përparim në këmbë të qelqta"](#). Raport nga Misioni për vlerësimin e situatës me lirinë e mediave. Shkup: 2023.

23 Magleshov, Vasko. ["Kuvendi ktheu reklamën shtetërore në mediat private"](#), Prizma, 29 shkurt 2024.

24 Opinioni i ekspertëve të angazhuar në projektin „BE për lirinë e shprehjes: harmonizimi i legjislacionit kombëtar të medias me ligjin e BE-së dhe standardet evropiane të medias”, në lidhje me ndryshimet shtesë të Ligjit për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizive të dorëzuar më 2 nëntor 2023. Opinioni është dorëzuar në Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës Publike më 6 nëntor 2023.

Dispozita e mëparshme e nenit 102 të LSHMAAV-së ndalonte plotësisht financimin e mediave private me fonde shtetërore²⁵. Në vitin 2023, SHGM ka reaguar për shkeljen e kësaj dispozite të ligjit. Kështu ndodhi me procedurën e Ministrisë së Punëve të Jashtme, e cila përmes një prokurimi publik të kryer më parë, ndau mjete për fushata në media private për promovimin e kryesimit të OSBE-së. Për qëllime të këtij raporti, SHGM ka dërguar një kërkesë me shkrim në zyrën e zëvendëskryeministrit për antikorupsion dhe qeverisje të mirë, me të cilën ka kërkuar informacion nëse institucionet shtetërore publikojnë rregullisht të dhënat për shumatat e akorduara për media të ndryshme në vendi për vitin 2023, por nuk ka marrë përgjigje.

— A.6 DISPOZITAT LIGJORE NË LIDHJE ME PUBLIKIMIN DHE ZBATIMIN NUK KRIJOJNË EFEKTE FRIKËSUESE PËR GAZETARËT DHE MEDIAN.

Më 17 nëntor 2022 u votuan dispozitat e reja të Ligjit për përgjegjësinë civile për fyerje dhe shpifje. Qëllimi i ndryshimeve ishte zvogëlimi i dënimeve të parapara për të mos ndikuar negativisht në gazetarinë e lirë dhe kritike. Ligji garanton lirinë e shprehjes dhe kufizimet e mundshme në rastet e dëmtimit të reputacionit dhe dinjitetit rregullohen në përputhje me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (neni 10) dhe praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. E meta kryesore e ligjit ishte masa e dëmshpërblimit që gjykata mund t'i caktojë gazetarit, si kompensim për dëmin jomaterial të shkaktuar nga fyerja ose shpifja, por me ndryshimet e miratuara ky rrezik është ulur ndjeshëm.

Në vitin 2023, sipas të dhënave të marra nga Gjykata Themelore Civile Shkup, nga 31.12.2023, numri i padive për shpifje dhe fyerje kundër gazetarëve dhe/ose mediave është zvogëluar dhe ka arritur në gjithsej 19. Në vitet e fundit, me disa përjashtime, paditë për shpifje dhe fyerje nuk kanë ndikuar negativisht në gazetarinë profesionale²⁶. Në vitin 2012, për shembull, kur kjo vepër u dekriminalizua, kishte rreth 330 padi dhe në vitet në vijim, numri u ul ndjeshëm, por në vitin 2022, numri i padive për shpifje dhe fyerje u rrit, kështu që numri i përgjithshëm. rastet aktive në të cilat palë është gazetar apo media u rritën në 54, në ndryshim nga viti 2021, kur ishte 20.

Në përgjithësi, perceptimi është se paditë për shpifje dhe fyerje janë përdorur më shumë si instrument presioni në të kaluarën. Rasti më karakteristik është padia për shpifje nga Koço Angjushev kundër IRL-së dhe kryeredaktores Sashka Cvetkovska për filmin dokumentar „Kospiracion kundër ajrit”. Sipas aktgjykimit të shpallur nga gjyqtarja Jovanka Spirovska-Paneva, IRL dhe Cvetkovska janë përgjegjëse për shpifje duke paraqitur fakte të pavërteta në pjesën e parë të hulumtimit „Kospiracion kundër ajrit” të transmetuar më 16 maj 2021 në RTM. Pas vendimit skandaloz të gjykatës, SHGM dhe SPGPM

25 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, „SHGM: Promovimi mediatic i MPJ-së me para publike është në kundërshtim me ndalimin e fushatave qeveritare”, 5 janar 2023.

26 Trpevska, Snezhana. „Analizë: Vendimet për shpifje dhe fyerje në çështje gjyqësore me gazetarë”, SHGM, 16 janar 2018.

organizuan një protestë gazetareske para gjykatës²⁷. Nën moton Të drejtat e qytetarëve para interesave të pushtetarëve, gazetarët dhe punonjësit e medias ngritën zërin kundër padrejtësive ndaj gazetarëve, gjë që kulmoi me vendimin kundër Laboratorit të Gazetarëve Hulumtues (IRL), me të cilin gjykata i ngarkoi vetes rolin e përcaktimit se kush mund dhe kush nuk mund të jetë gazetar. SHGM beson se gjykata nuk ka të drejtë të përcaktojë se cilat media online dhe organizata të shoqërisë civile lejohen të angazhohen në gazetari.

— A.7 LIGJET TJERA ZBATOHEN NË MËNYRË OBJEKTIVE DHE JU MUNDËSOJNË GAZETARËVE DHE AKTORËVE TË TJERË TË MEDIAVE TË PUNOJNË LIRSHËM DHE TË SIGURT

Në vend nuk ka mbrojtje ligjore kundër të ashtuquajturve paditë strategjike kundër pjesëmarrjes së publikut (SLAPP) me qëllim që të lodhen financiarisht mediat apo gazetarët. Kjo, megjithatë, nuk do të thotë se të pandehurit në procese të tilla mbeten pa mbrojtje, por ata ushtrojnë të drejtat e tyre, përkatësisht mbrojtjen në kuadër të ligjit pozitiv ekzistues. Këto raste, të çfarëdo natyre që mund të jenë, gravitojnë rreth disa ligjeve procedurale dhe materiale, si Ligji për Procedurën Civile (LPC), Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), ose Ligji për Përgjegjësinë Civile për Fyerje dhe Shpifje (LPCFSH)²⁸. Nga aspekti i mekanizmave të posaçëm mbrojtës të natyrës procedurale, në LPCSHF nuk ka dispozita të veçanta, përveç dispozitave të përgjithshme, të cilat i referohen fillimit të procedurës.

Në vitin 2023, nuk pati shembuj të zbatimit arbitrar apo diskriminues të ligjeve të tjera që synonin kufizimin e lirisë së punës gazetareske apo ngarkimin e medias me kosto përfaqësimi.

Sulmet fizike, fyerjet, nënçmimet, kërcënimet, dhuna online dhe paditë për shpifje janë praktikë e kohëpaskohshme për gazetarët në Maqedoni dhe në periudhën parazgjedhore kjo po bëhet gjithnjë e më e shpeshtë. Edhe pse vendi në vitin 2023 u rendit shumë lart për sa i përket lirisë së medias (e 38-ta nga 180 vende), dënimet për shpifje dhe fyerje u ulën në mënyrë drastike dhe u emërua një prokuror publik special që kujdeset për të drejtat e gazetarëve, megjithatë midis gazetarëve dhe punonjësve mediatik ka dyshime dhe frikë se mund të kthehen kohët kur mediat heshteshin. Shkak i frikës së tillë është fakti se në fund të vitit 2023 për IRL-në është dhënë aktgjykimi në mosmarrëveshjen me biznesmenin Koço Angjushev, në të cilin kontestohet se IRL është media dhe thuhet se gazetarët e IRL-së janë „të ashtuquajtur gazetarë”, se puna e tyre nuk është mund të jetë publike dhe se institucionet shtetërore duhet të rishqyrtojnë punën e tyre²⁹. IRL aktualisht po përballlet me tetë padi të hapura, pesë prej të cilave janë iniciuar nga

27 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, ["PROTESTË E GAZETARËVE SHGM dhe SPGPM - E drejta e qytetarëve para interesave të të fuqishmëve!"](#), 17 nëntor 2023.

28 Zharko Aleksov dhe Zharko Haxhi-Zafirov, ["ANALIZË - Si deri tek mbrojtja më efektive kundër padive strategjike kundër pjesëmarrjes publike \(SLAPP\)?"](#), Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë. Shkup: 2023.

29 Jovanovska, Sillobodanka. ["E vërteta apo interesat e biznesit: Kush dëshiron t'i heshtë gazetarët me paditë SLAPP?"](#). SHGM. 27 dhjetor 2023.

i njëjti biznesmen. Nga këtu, konkluzioni i përgjithshëm është se presioni kryesor ndaj gazetarëve kritikë tani vjen nga elita e biznesit dhe më pak nga të fuqishmit politikë.

— A.8 BESUESHMËRIA E BURIMEVE TË GAZETARËVE ËSHTË E GARANTUAR NË LEGJISLACION DHE RESPEKTOHET NGA AUTORITETET

Gazetarët ndjehen të lirë të kontaktojnë burimet e informacionit. Ligjet sigurojnë mbrojtje të mirë për burimet gazetareske³⁰. Megjithatë, një numër i vogël i informatorëve i raportojnë rastet tek institucionet kompetente ose te gazetarët, që do të thotë se tek burimet ende mbizotëron një atmosferë frike, e cila në fund të fundit nuk është e favorshme për vetë gazetarin.

Mbrojtja e burimeve gazetareske është e garantuar dhe e rregulluar në detaje në Kushtetutën e RMV-së dhe në disa ligje: Ligji për media, Ligji për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizive, Ligji për Përgjegjësinë Civile për Fyerje dhe Shpifje, Kodi Penal dhe Ligji për Mbrojtjen e Informatorëve. Gjatë vitit 2023 janë respektuar dispozitat e këtyre ligjeve, gjegjësisht SHGM nuk ka vërejtur raste të kufizimit të së drejtës së gazetarëve për mbrojtjen e burimeve.

Gjatë vitit 2023, SHGM nuk ka regjistruar asnjë raport për presion ndaj gazetarëve për të zbuluar burimet e tyre konfidenciale dhe gazetarët që punojnë në tekste investigative ndjehen të lirë të kontaktojnë burimet. Megjithatë, numri i individëve që raportojnë rastet e korrupsionit tek autoritetet kompetente dhe gazetarët është ende i ulët, edhe pse Ligji për Mbrojtjen e Informatorëve garanton të drejtat e informatorëve dhe rregullon raportimin e mbrojtur. Në këtë kuptim, burimet gazetareske inkurajohen dhe mbrohen më mirë institucionalisht, por për shkak të presioneve dhe frikës për vendin e punës, njerëzit rrallë guxojnë ta përdorin këtë mekanizëm.

— A.9 GAZETARËT JANË TË LIRË TË USHTROJNË PROFESIONIN E TYRE DHE TË THEMELOJNË, TË BASHKOHEN APO TË MARRIN PJESË NË SHOQATAT E TYRE

Profesioni i gazetarit nuk është subjekt i licencimit dhe nuk ka pasur tentativa nga shteti për të vendosur ndonjë kusht që dikush të punojë si gazetar. Dispozitat e Ligjit për Media janë tashmë të vjetruara, veçanërisht në lidhje me përkufizimin kufizues të termit gazetar³¹. Qeveria e RMV-së ka krijuar një sistem të ri akreditimi, sipas të cilit gazetarët dhe punonjësit e medias duhet të jenë anëtarë të SHGM-së³². Këto rregulla të reja të akreditimit nuk janë bërë në konsultim me palët e interesuara, përfshirë SHGM-në, dhe

30 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, „[Indeksi i sigurisë së gazetarëve në Ballkanin Perëndimor Maqedonia e Veriut - Raport Narrativ 2022](#)”. Shkup: 2023.

31 Ligji për Media (neni 2), Në nenin 2 të Ligjit për Media, termi gazetar përkufizohet si „një person që mbledh, analizon, përpunon ose klasifikon informacionin e publikuar në media dhe është i punësuar nga media ose ka një kontratë pune me ta, ose person që ushtron veprimtari gazetareske si profesion i pavarur (gazetar i pavarur)”.

32 „[SHGM dhe ASHMAAV dënuan qasjen selektive të qeverisë ndaj akreditimit të mediave](#)”. Radio MOF. 4 shkurt 2023.

në të ardhmen mund të jenë pengesë për disa gazetarë që të hyjnë në Qeveri për të mbuluar ngjarje mediatike.

Ndryshimet në Kodin Penal të miratuar në vitin 2023 parashikojnë disa risi kyçe që janë shumë të rëndësishme për mbrojtjen e gazetarëve dhe punonjësve të medias dhe që i referohen dispozitave ligjore për veprat e vrasjes, detyrimit dhe rrezikimit të sigurisë⁸⁶. Këto krime kanë marrë një formë të kualifikuar kur bëhet fjalë për gazetarët dhe punonjësit e medias, duke rritur dënimet për krimet e vrasjes apo detyrimit,

86 Bogdanov, Kostadin, Breshkovski, Ivan dhe Sekullovski, Dragan. „Përmirësimi i sigurisë së gazetarëve nëpërmjet ndryshimeve në Kodin Penal: Një analizë e standardeve ndërkombëtare dhe rregullativave të brendshme“, Fondacioni Konrad Adenauer në RMV dhe SHGM. Shkup: 2020.

si dhe për krimin e rrezikimit të sigurisë, përveç dënimeve më të larta për shkeljen e këtyre të drejtave të gazetarit apo një punonjësi tjetër mediatik, prokuroria do të veprojë sipas detyrës zyrtare. Është e rëndësishme që këto ndryshime të zbatohen vazhdimisht në të ardhmen, në mënyrë që autoritetet gjyqësore të demonstrojnë efektivitetin e mbrojtjes së të drejtave të gazetarëve, duke demotivuar sulmuesit dhe duke kontribuar në një mjedis pune më të sigurt për gazetarët.

Në vitin 2023 janë regjistruar dy raste të kërcënimeve të gazetarëve nëpërmjet internetit. Rasti i parë ka të bëjë me kërcënimet eksplicite ndaj gazetares së Alsat M-Rita Behadini, pas postimit të saj në Facebook lidhur me qëndrimin publik të hoxhës nga Saraji⁸⁷. Rasti i dytë ka të bëjë me themeluesin e Civil Media- Xhabir Deralla⁸⁸, i cili ka marrë kërcënime të drejtpërdrejta për jetën pasi ka publikuar një kolumnë në faqen zyrtare në Facebook të „Nova TV Web”.

Gjatë vitit të kaluar, në përgjithësi, është vërejtur një përmirësim i sjelljes së institucioneve në zgjidhjen e rasteve të kërcënimeve apo sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve të medias. Mirëpo, për dy rastet e regjistruara të kërcënimeve të adresuara në rrjetin social Facebook, deri në fund të vitit 2023 nuk kishin filluar ende procedurat e ndjekjes.

— C.9 HETIMET PËR TË GJITHA LLOJET E SULMEVE DHE DHUNËS NDAJ GAZETARËVE DHE AKTORËVE TJERË TË MEDIAVE ZHVILLOHEN NË MËNYRË TRANSPARENTE

Situata sa i përket transparencës së proceseve gjyqësore në të cilat palët janë gazetarë është e njëjtë si në vitet e fundit. Gjykata themelore civile dhe penale në Shkup nuk jep informacion të detajuar për procedurat gjyqësore për sulme ndaj gazetarëve, përveç nëse ka kërkesë për një rast konkret.

Gjykatat nuk kanë praktikë të informimit të publikut dhe as shoqatat e gazetarëve (SHGM dhe SPGPM) për procedurat lidhur me sulmet ndaj gazetarëve dhe mediave. SHGM në komunikim me shërbimet gjyqësore dhe prokuroriale marrin informacion dhe të dhëna për procedurat përkatëse për kërcënime dhe sulme ndaj gazetarëve apo punonjësve të medias. Vlerësimi i SHGM-së është se gjykatat dhe Prokuroria ka qenë transparente në zhvillimin e procedimeve për rastet e sulmeve dhe kërcënimeve që ndodhën në vitin 2023.

— C.10 NGA ORGANET SHTETËRORE JANË VENDOSUR SISTEMET PËR GRUMBULLIMIN E TË DHËNAVE STATISTIKORE CILËSORE PËR PARANDALIMIN E MOSNDËSHKIMIT

Situata nuk ka ndryshuar në krahasim me vitet e kaluara. Gjykatat dhe institucionet kompetente, përkundër iniciativave të SHGM-së, ende nuk kanë krijuar sisteme cilësore statistikore,

87 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë. „[Kërkojmë përgjegjësi penale për kërcënimet e qarta ndaj gazetares Rita Behadini](#)”. 24 korrik 2023.
88 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë. „[SHGM me kallëzim në MPB për kërcënim me jetë të Xhabir Derallës](#)”. 25 dhjetor 2023.

në bazë të të cilave mund të japin të dhëna të sakta për të gjitha proceset gjyqësore në të cilat palë janë gazetarët apo mediat. Shifrat për rastet gjyqësore kundër gazetarëve jepen përgjithësisht përmes komunikimit të drejtpërdrejtë ndërmjet përfaqësuesve të SHGM-së dhe zëdhënësve të autoriteteve gjyqësore. Sistemi aktual informatik – baza e informacioneve, nuk ofron mundësi për kërkim të detajuar dhe preciz lidhur me proceset aktuale dhe të kaluara ku si palë janë gazetarë, dhe kjo shërben si justifikim përse në organet e drejtësisë nuk ekziston një regjistër i posaçëm për shkeljen e të drejtave të punonjësve të medias.

Ministria e Brendshme ka krijuar një regjistër të brendshëm të të dhënave statistikore për sulmet dhe kërcënimet ndaj gazetarëve. As gjykata civile dhe as ajo penale në Shkup nuk janë në gjendje të japin informacion të detajuar në lidhje me rastet në të cilat gazetarët paraqiten si palë në procedurë. Bazat e të dhënave të gjykatave nuk lejojnë kërkimin e të dhënave sipas kriterëve të ndryshme.

Në të dhënat që SHGM i merr nga institucionet kompetente, vërehet një lloj kategorizimi i rasteve sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike.

— C.11 KËRCËNIMET DHE NGACMIMET QË NUK KANË TË BËJNË ME SIGURINË FIZIKE

Gjatë vitit të kaluar, sipas regjistrimit zyrtar të sulmeve dhe kërcënimeve të SHGM-së, nuk janë regjistruar sulme dhe kërcënime të tilla ndaj gazetarëve dhe punonjësve të mediave.

Kategoria	Numri	Përshkrim i shkurtër i rastit
Kërcënimet dhe ngacmimet që nuk kanë të bëjnë me sigurinë fizike Kjo kategori kërcënimesh dhe ngacmimesh përfshin: – mbikëqyrjen ose monitorimin; – telefonatat ngacmuese; – ngacmimin arbitrar gjyqësor ose administrativ; – deklarata agresive nga nëpunësit publikë; – forma të tjera presioni që mund të kërcënojnë sigurinë e gazetarëve gjatë kryerjes së punës së tyre. Këto lloj kërcënimesh nuk përfshijnë mobingun dhe dhunën në mjedisin e punës.	0	– Në vitin 2023, nuk u regjistrua asnjë rast i vetëm në këtë kategori.

— C.12 KËRCËNIMET NDAJ JETËS DHE SIGURISË FIZIKE TË GAZETARËVE

Gjatë vitit të kaluar, sipas regjistrimit zyrtar të sulmeve dhe kërcënimeve të SHGM ⁸⁹, janë regjistruar gjithsej tre kërcënime për jetën dhe sigurinë fizike të gazetarëve dhe punonjësve të medias.

I pari është rasti i gazetarit Ognen Janeski, të cilit i janë bërë dy kërcënime eksplicite për sigurinë e tij nga një shikues, në

89 Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë. [Regjistri i kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve të medias.](#)

dy emisione kontaktuese në TV 24⁹⁰. Në mënyrë të veçantë, gjatë emisionit „Vo tek” në televizionin 24, i cili është i formatit kontaktues, një teleshikues anonim ka kërcënuar seriozisht sigurinë fizike të të gjithë gazetarëve të televizionit, me një telefonatë shtesë në emisionin e pasdites „Oçi vo oçi”, e kërcënoi verbalisht gazetarin Janeski me fjalët: „... Faleminderit për padinë që do të bësh kundër meje. Dhe ne të dy do të takohemi në një vend tjetër, ku jeton ti!” Rasti është raportuar në MPB, si dhe në Prokurorinë Themelore Publike. Deri në fund të vitit 2023, rasti ishte ende në procedurë parahetimore.

Rasti i dytë ka të bëjë me kërcënimet eksplicite ndaj gazetares Rita Behadini, për shkak të postimit të saj në Facebook, lidhur me qëndrimin publik të hoxhës së Sarajit⁹¹. Konkretisht, bëhet fjalë për mesazhe online të dërguara nga një profil i quajtur Fisnik Hoxha, ku gazetares i kërkohet fshirja e postimit dhe i drejtohen ofendime ndaj familjes së saj dhe kërcënime ndaj sigorisë fizike. Rasti është raportuar në MPB dhe në Prokurorinë Publike, nga ku ndaj kërcënuesit pritët të ngrihet padi.

Rasti i tretë është kërcënimi i drejtpërdrejtë në formë komenti për Xhabir Derallën, themelues dhe drejtor i Civil Media⁹², për shkak të kolumnës së tij të publikuar në faqen zyrtare në Facebook të Nova TV Web. Nga profili me emrin Aleksandar Antiç është dërguar një koment me këtë përmbajtje: „Bëhu i dukshëm ndyrësisë, plumbi do të të arrijë le të jetë ku të jetë”. Deri në fund të vitit 2023, çështja ishte ende në procedim prokurorial.

Edhe pse në vitin 2023 ka vetëm një rast më shumë, krahasuar me vitin 2022, situata ende vlerësohet si e rëndë, pasi shkalla e mosndëshkimit të këtij lloj sulmesh është ende e lartë. Nga dhjetë sulmet që ndodhën në tre vitet e mëparshme, në 2020, 2021 dhe 2022, vetëm tre kanë një zgjidhje gjyqësore.

Kategoria	Numri	Përshkrim i shkurtër i rastit
Kërcënimet ndaj jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve Këto lloje kërcënimesh përfshijnë: – kërcënimet për vrasjen e gazetarëve, miqve të gazetarëve, anëtarëve të familjes së tyre ose burimeve të informacionit; – kërcënime për dëmtim fizik ndaj gazetarëve, miqve të gazetarëve, anëtarëve të familjes së tyre ose burimeve të informacionit. Këto kërcënime përfshijnë: – kërcënime direkte ose nëpërmjet personave të tretë; – dërgohet me mjete elektronike, apo në mënyrë të drejtpërdrejt; – implicite por edhe eksplicite.	3	– Kërcënime për sigurinë dhe jetën e Ognen Janeskit nga një shikues në dy emisione kontakti më 27 qershor 2023, në TV 24. – Kërcënime për Rita Behadinin pas postimit të saj në lidhje me qëndrimin publik të hoxhës nga Saraji në rrjetin social Facebook. – Kërcënim i drejtpërdrejtë për Xhabir Derallën në formë komenti në kolumnën e tij të publikuar në faqen zyrtare në Facebook të „Nova TV Web”

90 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë. „[Dënim i ashpër i kërcënimeve publike për dhunë ndaj gazetarëve dhe punëtorëve mediatik, të shprehur në një emision kontakti në TV24](#)”. 28 qershor 2023.

91 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë. „[Kërkojmë përgjegjësi penale për kërcënimet e qarta ndaj gazetares Rita Behadini](#)”. 24 korrik 2023.

92 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë. „[SHGM me kallëzim në MPB për kërcënimin me jetë ndaj Xhabir Derallës](#)”. 25 dhjetor 2023.

— C.13 SULMET E REALTA

Gjatë vitit të kaluar, sipas regjistrimit zyrtar të sulmeve dhe kërcënimeve të SHGM-së⁹³ janë regjistruar dy sulme fizike ndaj gazetarëve dhe punonjësve të medias.

Rasti i parë është sulmi ndaj ekipit televiziv të TV24 dhe kameramanit Ivan Kamçev⁹⁴. Si dëshmitarë të një aksidenti trafiku, Ivan Kamçev dhe kolegu i tij nga RTVM-ja kanë tentuar ta dokumentojnë ngjarjen, pas së cilës Kamçevi është sulmuar verbalisht dhe më pas fizikisht, me ç'rast i janë dëmtuar pajisjet. Pas kallëzimit në MPB dhe aktakuzës së dorëzuar, Gjykata në Kavadar ka dhënë aktgjykim dënues për sulmuesin⁹⁵.

Rasti i dytë ka të bëjë me sulmin ndaj ekipit televiziv të Alsat M në Shkup, në Çarshinë e Vjetër të Shkupit, kur ekipi u sulmua me gërshërë nga pronari i një floktarie⁹⁶. Ngjarja ka ndodhur teksa grupi po filmonte inserte në Çarshi, pronari, berber ka dalë me gërshërë nga një prej dyqaneve dhe i është drejtuar me ofendime verbale dhe kërcënime për jetën, duke i shkakuar dëmtime të dukshme në kokë kameramanit. Gjatë sulmit fizik janë dëmtuar edhe pajisjet e kameramanit.

Krahasuar me vitin 2022, viti 2023 është me një sulm fizik më pak. Sipas informacioneve të marra nga Prokuroria Themelore Publike, për sulmuesit në të dyja rastet tashmë janë shqiptuar dënime.

Kategoria	Numri	Përshkrim i shkurtër i rastit
Sulmet e realta Llojet e sulmeve reale ndaj gazetarëve mund të përfshijnë dëmtim të shkakuar fizik ose mendor, rrëmbim, hyrje në shtëpi ose zyrë, pajisje të sekuestruara, ndalim arbitrar, tentativa për atentat të dështuar, etj..	2	– Ekipi televiziv i TV24 dhe kameramani Ivan Kamçev u sulmuan në Kavadar nga L.R. – Ekipi i televizionit Alsat M është sulmuar në Shkup nga pronari i një floktarie.

— C.14 KËRCËNIMET DHE SULMET NDAJ MEDIAVE DHE SHOQATAVE TË GAZETARISË

SHGM nuk regjistroi asnjë sulm të këtij lloji në vitin 2023. Krahasuar me vitet e mëparshme në këtë dimension, situata mbetet e pandryshuar për këtë tregues.

Kategoria	Numri	Përshkrim i shkurtër i rastit
Kërcënimet dhe sulmet ndaj mediave dhe shoqatave të gazetarisë Sulme reale ndaj mediave dhe organizatave, personelit të tyre, pajisje të konfiskuara, deklarata agresive të zyrtarëve publikë, etj. Gjithashtu, kërcënimet dhe sulmet mund të përfshijnë disa nga kategoritë e mësipërme.	0	– Në vitin 2023, nuk u regjistrua asnjë rast i vetëm në këtë kategori.

93 Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë. ["Regjistri i kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve të medias"](#).

94 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë. ["Dënim për sulmin fizik ndaj kameramanit të TV24, Ivan Kamçev"](#). 18 korrik 2023.

95 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë. ["SHGM: Aktgjykim dënues për sulmuesin e kameramanit Ivan Kamçev nga 24TV"](#). 13 nëntor 2023.

96 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë. ["SHGM: Sulmohen gazetarët, i plagosur kameramani i ALSAT-it, kërkojmë reagim të menjëhershëm nga Ministria e Brendshme"](#). 21 gusht 2023.



Konkluzat dhe rekomandime

KONKLUSIONE

GARANCITË LIGJORE DHE ZBATIMI I TYRE

Në fillim të vitit 2023 u votuan ndryshimet dhe plotësimet në Kodin Penal të RMV-së, sipas të cilave sulmi ndaj gazetarit apo punonjësit të medias do të trajtohet si sulm ndaj një zyrtari. Në disa vepra penale është shtuar një formë e kualifikuar dhe është parashikuar një dënim më i lartë për kryerjen e atij krimi ndaj gazetarëve. Pritet që këto ndryshime të kenë efekt parandalues sepse ofrojnë zgjidhje sistematike në kuadrin ligjor me të cilin gazetarët dhe punonjësit e medias janë më të mbrojtur në kryerjen e punës së tyre. Është e një rëndësie të veçantë krijimi i një praktike pozitive gjyqësore në të ardhmen me zbatimin konsekuent të këtyre ndryshimeve, në mënyrë që autoritetet gjyqësore të kenë një ndikim më të madh në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të gazetarëve. Në vitin 2023 u zhvillua procesi reformues i politikës mediatike të vendit, i cili u mbështet nga Bashkimi Evropian. Faza e parë e këtij procesi përfundoi me harmonizimin e Ligjit për Shërbimet Mediatik Audio dhe Audiovizive me Direktivën kryesore të BE-së në këtë fushë dhe me përmirësimin e zgjidhjeve financuese të rregullatorit dhe servisit publik. Megjithatë, në fazën e dytë, Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës (MSHIA), megjithëse publikisht shprehu angazhimin e saj për zbatimin e plotë dhe transparent të reformave, në fund të vitit propozoi vetëm zgjidhje të pjesshme, të cilat ishin me interes për një pjesë të sektorit të medias private. Kundër këtyre zgjidhjeve ishin shoqatat dhe organizatat e gazetarëve dhe mediave, duke theksuar se në vend që të rikthehet reklama shtetërore në mediat private, duhet futur një fond për pluralizmin e përmbajtjeve mediatike. Të gjitha mangësitë e tjera në kuadrin ligjor, të identikuara gjatë viteve të kaluara si pengesë për zhvillimin e lirive të medias dhe gazetarisë dhe për pluralizmin e përmbajtjes mediatike, nuk u morën parasysh dhe mbeten çështje shqetësuese edhe për të ardhmen. Qëllimi i dispozitave të reja në Ligjin për Përgjegjësinë

Civile për Fyerje dhe Shpifje, i cili u miratua në vitin 2022, ishte zvogëlimi i dënimeve të parapara për të mos ndikuar negativisht në gazetarinë e lirë dhe kritike. Ligji garanton lirinë e shprehjes dhe kufizimet e mundshme në rastet e dëmtimit të imazhit dhe dinjitetit, që rregullohen në përputhje me nenin 10 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nga të ashtuquajturat paditë strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP) qëllimi kryesor i të cilave është rraskapitja financiare e medias apo gazetarëve. Kjo, megjithatë, nuk do të thotë se të pandehurit në procese të tilla mbeten pa mbrojtje, por ata ushtrojnë të drejtat e tyre, përkatësisht mbrojtjen në kuadër të ligjit pozitiv ekzistues.

POZITA E GAZETARËVE NË REDAKSI

Statusi i punës së shumë gazetarëve, veçanërisht në mediat private, është i pasigurt, pasi një numër i madh gazetarësh, edhe pse të punësuar me kontrata afatgjata të pacaktuara, kanë të ardhura nën nivelin e pagës mesatare në vend, punojnë më shumë se orët e punës që janë përcaktuar me ligj, nuk marrin kompensim jashtë orarit të punës dhe punës në ditë festash dhe janë vazhdimisht të ekspozuar ndaj stresit, sepse duhet të punojnë në shumë detyra të ndryshme në redaksi me numër të vogël punonjësish. Rreth një e pesta e numrit të përgjithshëm të gazetarëve dhe punonjësve të medias janë ende të punësuar me kontrata me afat të caktuar ose kontrata në vepër, dhe kjo është praktika më e zakonshme në televizionet private dhe mediat online. Për shkak të gjithë kësaj, gazetarët janë shumë më të prekshëm ndaj presioneve nga strukturat drejtuese, pronarët dhe politikanët. Presionet janë kryesisht të fshehura dhe pak të dukshme, gazetarët përmbahen nga të folurit hapur për këto dukuri dhe rrallë raportojnë kur u shkelen të drejtat themelore. Edhe pse vlerësohet se gazetarët në redaksi në përgjithësi kanë më shumë liri, sërish ka shumë ndikime në punën e përditshme, të cilat nuk janë edhe aq të dukshme, pra ka më shumë autocensurë sesa presione të drejtpërdrejta. Më e keqja është pozita e gazetarëve në mediat lokale dhe rajonale, për faktin se këto media janë në gjendje të keqe financiare, e përveç kësaj, në zona të vogla, pushtetarët lokalë mund të ushtrojnë më lehtë presion. Statusi i punës dhe pozicioni i gazetarëve femra në redaksi nuk ndryshon shumë nga ai i kolegeve të tyre gazetare, me përjashtim të faktit se ka më pak gra në poste drejtuese në media.

SIGURIA E GAZETARËVE

Në vitin 2023, numri i sulmeve ndaj gazetarëve u reduktua. Megjithatë, edhe pse numri i kërcënimeve verbale dhe fizike është në rënie krahasuar me vitet e kaluara, shqetësues është fakti që gazetarët dhe profesionistët e medias janë gjithnjë e më shpesh objekt kërcënimesh dhe ngacmimesh në hapësirën online, pra në rrjetet sociale. Disa nga këto sulme ishin kërcënime të qarta për sigurinë fizike të gazetarëve që punojnë në hetime për korrupsionin dhe forma të tjera të krimit dhe veprimtarisë së paligjshme. Institucionet dhe gjykatat kompetente ende nuk mbajnë shënime mjaftueshëm të përditësuara për kërcënimet dhe sulmet ndaj gazetarëve dhe as

nuk i publikojnë të dhënat e tilla. Megjithatë, është pozitive që institucionet kompetente janë të hapura për bashkëpunim me shoqatat gazetareske dhe përmes konsultimeve të përbashkëta tregojnë gatishmëri për të punuar në përmirësimin e sigurisë së gazetarëve dhe punonjësve të medias, përmes masave më të shpejta dhe ndjekjes penale të autorëve të sulmeve dhe kërcënimeve. Nga gjithsej pesë raste të regjistruara të sulmeve ndaj gazetarëve në vitin 2023, dy raste kanë përfunduar me dënime të plotfuqishme, ndërsa tre rastet e mbetura janë në fazën e hetimit në Prokurorinë Themelore Publike (PTHP). Një prokuror i ri kompetent në Prokurorinë Themelore Publike dhe tre prokurorë publikë specialë për rajonin e Tetovës, Manastirit dhe Shtipit, të cilët do të monitorojnë procedurat në rastet në të cilat janë sulmuar gazetarët. Përmes linjës së posaçme të krijuar për komunikim me Prokurorinë Publike, gazetarët do të mund të informohen për rrjedhën e procedurës për sulmet fizike dhe dhunën. Megjithatë, ende nuk ka udhëzime të veçanta të miratuara nga MPB-ja dhe Prokuroria Publike për zbulimin dhe ndjekjen efektive të autorëve të sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve.

KONKLUZË E PËRGJITHSHME

Ndryshimet në Kodin Penal të miratuara në fillim të vitit 2023 forcuan ndjeshëm mbrojtjen ligjore të gazetarëve dhe punonjësve të medias. Shteti ka shënuar progres pozitiv në indekset për liritë e medias dhe sigurinë e gazetarëve, falë këtyre ndryshimeve ligjore që sigurojnë mbrojtjen sistematike të gazetarëve. Pavarësisht kësaj, zbatimi i qëndrueshëm dhe efikas i këtyre dispozitave ligjore mbetet sfida, për të krijuar praktikë pozitive gjyqësore në sanksionimin e sulmeve ndaj gazetarëve. Një problem serioz, i cili reflektohet në punën e institucioneve kyçe mediatike – organit rregullativ për media dhe shërbimit publik mediatik, është zvarritja shumëvjeçare e procedurës për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të ASHMAAV dhe Këshillit Programor të RTM-së. Propozimet për ligje të reja për mediat të bëra në kuadër të procesit të reformës mediatike të mbështetur nga BE-ja, në kuadër të të cilit rekomandohet krijimi i një Fondi për Pluralizëm dhe Diversitet të Përmbajtjes, nuk u pranuan nga institucionet kompetente. Në vend të kësaj, u propozuan ndryshime në Ligjin për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizive, të cilat përsëri lejojnë reklamimin shtetëror në mediat private audiovizive, gjë që mbart rrezikun e forcimit të lidhjeve klienteliste ndërmjet mediave private dhe qeverisë në dëm të interesit publik dhe pavarësisë së redaksitë në këto media. Dispozitat e Kodit Zgjedhor nuk përmbajnë rregulla të qarta për reklamimin politik me pagesë në sektorë të ndryshëm mediatik, gjë që krijon mundësi për keqpërdorim të fondeve publike. Kushtet e pasigurta socio-ekonomike, pagat e ulëta dhe mosrespektimi i të drejtave të punës janë ndër problemet më serioze me të cilat përballen gazetarët, gjë që ndikon drejtpërdrejt në ndjenjën e tyre të sigurisë dhe pavarësisë në mjedisin e punës. Edhe pse numri i kërcënimeve dhe sulmeve eksplicite ndaj gazetarëve dhe punonjësve të medias është ulur ndjeshëm në krahasim me vitet e mëparshme, presioni ndaj redaksive kritike nga njerëz të fuqishëm me padi për shpifje dhe fyerje është një shqetësim. Institucionet

kompetente gjyqësore ende nuk kanë krijuar sisteme për regjistrimin dhe ndjekjen e sulmeve ndaj gazetarëve.

REKOMANDIME

A: GARANCITË LIGJORE DHE ZBATIMI I TYRE

- Zbatimi i procedurës së përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të ASHMAAV dhe Këshillit Programor të RTM-së nga Kuvendi i RMV-së.
- Procedura të zhvillohet në mënyrë transparente, me dëgjim publik të të gjithë kandidatëve, ndërsa parimi i shumicës së dy të tretave duhet të ruhet në procesin e vendimmarrjes së Kuvendit.
- Nevojitet një analizë e dispozitave të Ligjit për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe ligjeve të tjera përkatëse në drejtim të përmirësimit të gjendjes financiare të mediave private dhe futjes së mekanizmave për lehtësim tatimor dhe përfitime të ngjashme për mediat.
- Është e nevojshme të hapet urgjentisht një debat për krijimin e mundshëm të një fondi për median, veçanërisht për qëllimet dhe kriteret e mbështetjes financiare (nxitja e diversitetit të programeve, përmirësimi i statusit të gazetarëve, etj.), mënyra e shpërndarjes së fondeve, pavarësia dhe objektiviteti në zbatimin e procedurës.
- Nevojiten ndryshime dhe shtesa në Kodin Zgjedhor, të cilat do të thjeshtojnë rregullat për fushatën mediatike dhe do të ulin mundësinë e abuzimit me reklamat politike me pagesë në mediat private.
- Inicimi i ndryshimeve dhe plotësimeve në Kodin e Etikës për gazetarët në servis publik RTM për të forcuar vetërregullimin e brendshëm në këtë media.

B: POZITA E GAZETARËVE NË REDAKSI

- Vazhdimi i përpjekjeve të SPGPM-së, me mbështetjen e SHGM-së, për nënshkrimin e kontratave të reja kolektive me mediat private.
- Realizimi i fushatave dhe trajnimeve, përmes të cilave gazetarët dhe punonjësit e medias do të njiheshin më shumë me të drejtat e tyre elementare të punës.
- Të vazhdojë ofrimi i asistencës ligjore dhe shërbimeve këshillimore për gazetarët dhe punonjësit e medias nga shoqatat e gazetarëve.
- Intensifikimi i bashkëpunimit dhe dialogut me institucionet në interes të mbrojtjes së të drejtave të punës.

C: FORCIMI I SIGURISË SË GAZETARËVE:


- Krijimi i regjistrave të posaçëm për çështjet e padive kundër gazetarëve, pranë gjykatave themelore civile dhe penale, duke përfshirë PTHP-në.
- Zbatimi efektiv i ligjeve për siguri më të mirë të gazetarëve dhe punonjësve të medias.
- Një proces i vazhdueshëm në ngritjen e kapaciteteve të gazetarëve, avokatëve, gjyqtarëve dhe prokurorëve për temat që kanë të bëjnë me sanksionimin e sulmeve ndaj gazetarëve dhe interpretimin e përgjithshëm të nenit 10 të GJEDNJ.
- Përmirësimi i bashkëpunimit me përfaqësuesit e sapozgjedhur të Kuvendit të RMV-së për temat që kanë të bëjnë me lirinë e shprehjes dhe politikat e medias.
- Vazhdimi i lobimit të SHGM-së për futjen e protokolleve dhe përmirësimin e procedurave të brendshme në institucione, me qëllim parandalimin e dhunës ndaj gazetarëve dhe sanksionimin efektiv të saj.
- Është e nevojshme që SHGM të përmirësojë bashkëpunimin me Avokatin e Popullit.

IV Indeksi i sigurisë së gazetarëve në Maqedoninë e Veriut – 2023

Ky seksion i raportit paraqet grafikisht Indeks të Sigurisë së Gazetarëve në vitin 2023, krahasuar me vitin e kaluar 2022. Për secilin nga katër dimensionet dhe për të 19 treguesit, jepet një shpjegim i shkurtër i ndryshimeve kryesore që ndodhën në vitin 2023.

Një shpjegim më i gjerë i të dhënave dhe ndryshimeve të ndodhura për secilin tregues individual të Indeksit mund të lexohet në pjesën narrative të raportit:

Treguesit e Indeksit të Sigurisë së Gazetarëve	Raport narrativ
I. Mjedisi ligjor dhe organizativ	
Dispozitat ligjore në lidhje me shpifjen dhe zbatimin e tyre nuk krijojnë efekte frikësuese ndaj gazetarëve dhe mediave	A.6
Besueshmëria e burimeve të gazetarëve është e garantuar në legjislacion dhe respektohet nga autoritetet	A.8
Ligjet tjera zbatohen në mënyrë objektive dhe ju mundësojnë gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave të punojnë lirshëm dhe të sigurt	A.7
Gazetarët janë të lirë të ushtrojnë profesionin e tyre dhe të themelojnë, të bashkohen apo të marrin pjesë në shoqatat e tyre	A.9
Pozita e gazetarëve në vendin e punës është e qëndrueshme dhe e mbrojtur	B.1
II. Parandalimi	
Gazetarët dhe aktorët tjerë mediatik kanë qasje në masat e shpejta dhe efektive mbrojtëse kur ekspozohen ndaj kërcënimeve	C.1
Gazetarët dhe aktorët e tjerë të mediave (jeta ose integriteti fizik i të cilëve është realisht në rrezik të drejtpërdrejtë) kanë qasje në mekanizma të veçantë për mbrojtje/siguri	C.2
Gazetarët femra kanë qasje në masat ligjore dhe mekanizmat mbështetëse kur përballen me kërcënime, ngacmime dhe dhunë me bazë gjinore	C.3
Është vendosur praktikë e dënimit të rregullt publik të rasteve të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe mediave	C.4
Zyrtarët policor janë të ndjeshëm në çështjen e mbrojtjes së gazetarëve	C.5
III. Procesi	
Njësitë dhe/ose zyrtarët e specializuar hetimorë janë të pajisur me ekspertizën përkatëse për hetimin e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve	C.6
Hetimet për sulmet e rënda fizike ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë mediatik zhvillohen me efikasitet (në mënyrë të pavarur, rrënjësore dhe të shpejtë)	C.7
Gazetarët dhe aktorët e tjerë të mediave mbrohen në mënyrë efektive nga forma të ndryshme të ngacmimit në internet	C.8
Hetimet për të gjitha llojet e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve dhe aktorëve tjerë të mediave zhvillohen në mënyrë transparente	C.9
Nga organet shtetërore janë vendosur sistemet për grumbullimin e të dhënave statistikore cilësore për parandalimin e mosndëshkimit	C.10
IV. Siguria reale	
Kërcënimet dhe ngacmimet që nuk kanë të bëjnë me sigurinë fizike	C.11
Kërcënimet ndaj jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve	C.12
Sulmet e realja	C.13
Kërcënimet dhe sulmet ndaj mediave dhe shoqatave të gazetarisë	C.14



	2022	2023		Ndryshimet e reja kryesore për secilin dimension
Mjedisi ligjor dhe organizativ	4.17	4.11	↓	Vitin e kaluar, numri i rasteve kundër gazetarëve dhe mediave në Maqedoninë e Veriut u zvogëlua, por politika e përgjithshme e mosndëshkimit vazhdon në lidhje me rastet e vjetra të sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve të mediave. Kurse në vitin 2023, për shkak të mungesës së vullnetit politik, nuk u zgjodhën anëtarë të rinj në Këshillin Programor të RTVM-së dhe në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Reformat në media u zbatuan vetëm pjesërisht. Shqetësim i veçantë është kthimi i reklamave qeveritare në mediat private audiovizive, si dhe tendenca në rritje e përdorimit të padive strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP) për të mbyllur gojën e gazetarëve dhe punonjësve të medias në vend. Ndryshimet në Kodin Penal u miratuan në vitin 2023, të cilat kontribuojnë në rritjen e sigurisë së gazetarëve dhe punonjësve të medias.
Parandalimi	3.83	3.83	—	Për sa i përket qasjes së gazetarëve ndaj masave të shpejta dhe efektive të mbrojtjes në rastet e kërcënimeve dhe sulmeve, ka pasur një përmirësim të lehtë në vitin 2023. Gjithashtu u emëruan prokurorë të rinj në tre zona të apelit në të gjithë vendin, përgjegjës për monitorimin e procedimeve në rastet në të cilat sulmohen gazetarët, si dhe u hap një linjë speciale për të thirrur gazetarët dhe punonjësit e medias.
Procesi	3.38	3.38	—	Perceptimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve kompetente në vitin 2023 është përmirësuar dhe ka rezultuar në efikasitet më të madh të tyre në zbulimin e autorëve të sulmeve. Nga gjithsej 5 kërcënime dhe sulme ndaj gazetarëve dhe punonjësve të medias, dy u hetuan dhe përfunduan me dënim për sulmuesit.
Siguria reale	4.09	4.09	—	Numri i sulmeve fizike dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve është ulur krahasuar me vitin e kaluar. Megjithatë, shkalla e mosndëshkimit për këtë lloj sulmesh është ende e lartë, për faktin se një numër i konsiderueshëm i rasteve nga vitet e kaluara ende nuk janë hetuar.
Indeksi i sigurisë së gazetarëve	3.92	3.91	↓	

Mjedisi ligjor dhe organizativ

Dispozitat ligjore në lidhje me shpifjen dhe zbatimimi i tyre nuk krijojnë efekte frikësuese ndaj gazetarëve dhe mediave

4.22

Besueshmëria e burimeve të gazetarëve është e garantuar në legjislacion dhe respektohet nga autoritetet

4.83

Ligjet tjera zbatohen në mënyrë objektive dhe ju mundësojnë gazetarëve dhe aktorëve të tjerë mediave të punojnë lirshëm dhe të sigurt


4.02

Gazetarët janë të lirë të ushtrojnë profesionin e tyre dhe të themelojnë, të bashkohen apo të marrin pjesë në shoqatat e tyre

4.19

Pozita e gazetarëve në vendin e punës është e qëndrueshme dhe mbrojtur

3.29



INDIKATORI 1.1

— DISPOZITAT LIGJORE NË LIDHJE ME SHPIFJEN DHE ZBATIMI I TYRE NUK KRIJOJNË EFEKTE FRIKËSUESE NDAJ GAZETARËVE DHE MEDIAVE

Rezultati për vitin 2022: 4.34 / Rezultati për vitin 2023: 4.22

Rezultati i përgjithshëm për këtë tregues në vitin 2023 është pak më i keq krahasuar me atë të mëparshëm, kryesisht për shkak të tendencës së rritjes së numrit të padive për shpifje apo fyerje ndaj gazetarëve dhe mediave, si dhe për shkak të vendimit të gjykatës për shpifje kundër Laboratorit të Gazetarëve Hulumtues (IRL) në rastin e ish zëvendëskryeministrit Koço Angjushev. Mirëpo, edhe këtë vit gazetarët nuk e vlerësojnë ligjin për përgjegjësi civile për shpifje dhe fyerje si kufizues për punën e tyre.

INDIKATORI 1.2

— BESUESHMËRIA E BURIMEVE TË GAZETARËVE ËSHTË E GARANTUAR NË LEGJISLACION DHE RESPEKTOHET NGA AUTORITETET

**Rezultati për vitin 2022: 4.80 /
Rezultati për vitin 2023: 4.83**

Krahasuar me vitin e kaluar, në vitin 2023 ka një përmirësim të lehtë të këtij treguesi, për shkak të mekanizmave të përforcuar për mbrojtjen e burimeve gazetareske – garancitë ligjore për raportimin e mbrojtur, të drejtat e informatorëve, si dhe veprimin më efikas të institucioneve në lidhje me raportimin e mbrojtur dhe sigurimin e mbrojtjes për sinjalizuesit. Gazetarët që punojnë në tema investigative që lidhen me korrupsionin ose krimin në përgjithësi ndjehen të lirë të kontaktojnë burimet e informacionit. Megjithatë, megjithëse informatorët (si një grup i rëndësishëm burimesh gazetareske) janë më të mbrojtur ligjërisht dhe institucionalisht, vetëm një numër i vogël raporton rastet me iniciativën e tyre tek institucionet kompetente apo gazetarët.

INDIKATORI 1.3

— LIGJET TJERA ZBATOHEN NË MËNYRË OBJEKTIVE DHE JU MUNDËSOJNË GAZETARËVE DHE AKTORËVE TË TJERË TË MEDIAVE TË PUNOJNË LIRSHËM DHE TË SIGURT

Rezultati për vitin 2022: 4.21 / Rezultati për vitin 2023: 4.02

Situata për sa i përket këtij treguesi është disi më e keqe krahasuar me vitin 2022 sepse shteti ende nuk ka ndërmarrë veprime për të vendosur mbrojtjen ligjore ndaj të ashtuquajturave padi të pabaza kundër gazetarëve dhe mediave për t'i raskapitur financiarisht (paditë SLAPP). Një praktikë e tillë është regjistruar në vend me disa raste, të cilat tregojnë qartë se është një përpjekje e pushtetarëve për të ushtruar presion ndaj gazetarëve. Krahasuar me vitin 2022, në vitin 2023 numri i padive të tilla SLAPP kundër gazetarëve dhe punonjësve të medias është rritur.

INDIKATORI 1.4

— GAZETARËT JANË TË LIRË TË USHTROJNË PROFESIONIN E TYRE DHE TË THEMELUJNË, TË BASHKOHEN APO TË MARRIN PJESË NË SHOQATAT E TYRE

Rezultati për vitin 2022: 4.14 / Rezultati për vitin 2023: 4.19

Në vitin 2023, gjendja në lidhje me ushtrimin e lirë të profesionit të gazetarit është përmirësuar pak në krahasim me një vit më parë, para së gjithash për faktin se është rritur ndërgjegjësimi i komunitetit të gazetarëve dhe solidariteti, si dhe është rritur numri i anëtarëve në shoqata dhe sindikata. Tre shoqata profesionale janë aktive, por është ende e rëndësishme të punohet për qëndrueshmërinë e tyre. Nuk ka pasur presione serioze mbi shoqatat, por ka rezistencë tek pronarët apo drejtuesit e mediave private që gazetarët të anëtarësohen në sindikatat e gazetarëve dhe të krijojnë organizata sindikale.

INDIKATORI 1.5

— POZITA E GAZETARËVE NË VENDIN E PUNËS ËSHTË E QËNDRUESHME DHE E MBROJTUR

Rezultati për vitin 2022: 3.34 / Rezultati për vitin 2023: 3.29

Situata me të drejtat e punës dhe statusi i punës së gazetarëve nuk u përmirësua as në vitin 2023. Një numër i madh gazetarësh në mediat private nuk kanë nënshkruar kontrata pune, punojnë jashtë orarit ose të ardhurat e tyre janë të ulëta dhe të parregullta. Gazetarët në mediat private kanë frikë të nisin procedura ligjore për mobing ose mosrespektim të të drejtave të punës dhe të krijojnë organizata sindikale në media. Në servis publik gjendja është disi më e mirë, gazetarët kanë kontrata pune, ka edhe një organizatë sindikale me një numër përfaqësues anëtarësh.



Parandalimi



INDIKATORI 2.1

— GAZETARËT DHE AKTORËT TJERË MEDIATIK KANË QASJE NË MASAT E SHPEJTA DHE EFEKTIVE MBROJTËSE KUR EKSPOZOHEN NDAJ KËRCËNIMEVE

Rezultati për vitin 2022: 3.75 / Rezultati për vitin 2023: 3.83

Gjatë vitit 2023, ka pasur disa përmirësime në qasjen e gazetarëve ndaj masave të shpejta dhe efektive të mbrojtjes në rastet e kërcënimeve dhe sulmeve. Përveç prokurorit special të emëruar në Prokurorinë Themelore Publike, përgjegjës për monitorimin e procedurave në rastet në të cilat sulmohen gazetarët, është rritur kompetenca e tre prokurorëve të tjerë në tri fusha të tjera të apelit, si dhe është hapur linja speciale në të cilën mund të telefonojnë gazetarët. Nga pesë sulmet e regjistruara ndaj gazetarëve, vetëm dy përfunduan me një vendim gjykatë që sanksiononte sulmuesit, ndërsa tre të tjerët janë ende në procedurë prokuroriale.

INDIKATORI 2.2

— GAZETARËT DHE AKTORËT E TJERË TË MEDIAVE (JETA OSE INTEGRITETI FIZIK I TË CILËVE ËSHTË REALISHT NË RREZIK TË DREJTPËRDREJTË) KANË QASJE NË MEKANIZMA TË VEÇANTË PËR MBROJTJE/ SIGURI

Rezultati për vitin 2022: 3.42 / Rezultati për vitin 2023: 3.45

Gjatë vitit 2023 nuk ka pasur ndryshime të mëdha në lidhje me qasjen e gazetarëve në masat e mbrojtjes fizike në rastet e kërcënimeve serioze për sigurinë e tyre. Në ligj ka dispozita që garantojnë masa të posaçme për mbrojtjen e gazetarëve, por procedura për vlerësimin e rrezikut nuk është e përcaktuar mjaft qartë, ndaj nuk dihet se sa është e zbatueshme në praktikë. Masat e sigurimit propozohen nga prokurori publik, të cilat caktohen nga gjyqtari në procedurë paraprake, në bazë të vlerësimit të peshës së situatës, llojit të krimit, rrezikshmërisë për viktimën etj.

INDIKATORI 2.3

— GAZETARET KANË QASJE NË MASAT LIGJORE DHE MEKANIZMAT MBËSHTETËSE KUR PËRBALLEN ME KËRCËNIME, NGACMIME DHE DHUNË ME BAZË GJINORE

**Rezultati për vitin 2022: 3.64 /
Rezultati për vitin 2023: 3.60**

Në vitin 2023, në krahasim me vitet e kaluara situata në lidhje me këtë tregues nuk është përmirësuar. Pavarësisht masave të inkorporuara në Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Familje, mekanizmi i krijuar për ndihmë juridike falas në Ministrinë e Drejtësisë pothuajse nuk përdoret fare për të mbështetur viktimat e sulmeve dhe dhunës me bazë gjinore, përfshirë gazetaret femra. Në vitin 2023, dy raste u raportuan në SHGM, një kërcënim në internet ndaj një gazetari dhe një sulm fizik ndaj një gazetari, megjithëse numri i tyre në hapësirën online është në fakt shumë më i lartë.

INDIKATORI 2.4

— ËSHTË VENDOSUR PRAKTIKË E DËNIMIT TË RREGULLT PUBLIK TË RASTEVE TË KËRCËNIMEVE DHE SULMEVE NDAJ GAZETARËVE DHE MEDIAVE

**Rezultati për vitin 2022: 3.58 /
Rezultati për vitin 2023: 3.46**

Vërehet një përkeqësim i lehtë i situatës në këtë tregues, krahasuar me vitin e kaluar, pasi janë regjistruar disa shembuj të sulmeve verbale ndaj gazetarëve nga bartës të funksioneve publike. Ndryshe, vlerësimi i përgjithshëm është se në vitet e kaluara është krijuar një praktikë e dënimit publik të sulmeve ndaj gazetarëve, dhe bartësit e posteve publike kryesisht janë përmbajtur nga sulmet verbale ndaj gazetarëve. Megjithatë, ekziston një mungesë konsistence në një praktikë të tillë në mesin e të gjithë zyrtarëve relevantë politikë dhe qeveritarë.

INDIKATORI 2.5


— ZYRTARËT POLICOR JANË TË NDJESHËM NË ÇËSHTJEN E MBROJTJES SË GAZETARËVE

Rezultati për vitin 2022: 4.77 / Rezultati për vitin 2023: 4.79

Sa i përket sjelljes së policisë ndaj gazetarëve, nuk ka pasur ndryshime të mëdha. Policia gjatë vitit 2023 ka shfaqur sjellje korrekte ndaj gazetarëve dhe mediave në situata të ndryshme. Ky është rezultat i një sërë aktiviteteve të përbashkëta të SHGM-së dhe autoriteteve policore gjatë viteve të fundit: SHGM, në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, përgatiti një Protokoll për Sigurinë në hapësirën online për gazetaret femra. Në kuadër të këtij bashkëpunimi janë botuar disa manuale, të dedikuara si për gazetaret ashtu edhe për punonjësit e policisë.



Procesi



INDIKATORI 3.1

— NJËSITË DHE/OSE ZYRTARËT E SPECIALIZUAR HETIMORË JANË TË PAJISUR ME EKSPERTIZËN PËRKATËSE PËR HETIMIN E SULMEVE DHE DHUNËS NDAJ GAZETARËVE

**Rezultati për vitin 2022: 3.43 /
Rezultati për vitin 2023: 3.43**

Në vitin 2023, situata në lidhje me këtë tregues nuk ka ndryshuar. Nuk janë miratuar ende udhëzime specifike që mund të ndihmojnë në kryerjen e hetimeve në mënyrë më efikase. Ndryshim pozitiv është emërimi i tre prokurorëve të rinj në tre zona të reja të Apelit, të cilët do të monitorojnë procedimet në rastet kur sulmohen gazetarët. Megjithatë, prokurorët publikë janë ende shumë inertë sa i përket fillimit të procedurës.

INDIKATORI 3.2

— HETIMET PËR SULMET E RËNDA FIZIKE NDAJ GAZETARËVE DHE AKTORËVE TË TJERË MEDIATIK ZHVILLOHEN ME EFIKASITET (NË MËNYRË TË PAVARUR, RRËNJËSORE DHE TË SHPEJTË)

**Rezultati për vitin 2022: 3.49 /
Rezultati për vitin 2023: 3.48**

Megjithëse mosndëshkimi është ende një problem i madh, perceptimi është se ka një kthim të lehtë në vitin 2023, krahasuar me vitet e mëparshme, kryesisht për shkak të problemit të hetimeve të ngadalta dhe joefektive, dhe për shkak të sulmeve të veçanta ndaj gazetarëve në dhjetë vitet e fundit, për të cilat madje nuk janë nisur fare hetime.

INDIKATORI 3.3

— GAZETARËT DHE AKTORËT E TJERË TË MEDIAVE MBROHEN NË MËNYRË EFEKTIVE NGA FORMA TË NDRYSHME TË NGACMIMIT NË INTERNET

Rezultati për vitin 2022: 3.46 / Rezultati për vitin 2023: 3.51

Gjatë vitit 2023 është vërejtur një përmirësim i lehtë në mbrojtjen e gazetarëve nga kërcënimet online, për faktin se institucionet kompetente (në veçanti Ministria e Brendshme) kanë reaguar për gjetjen e personave që kanë kërcënuar seriozisht jetën e gazetarëve përmes rrjetit social Facebook. Në vitin 2023 në Prokurorinë Themelore Publike janë duke u zhvilluar tri raste për tri raste të sulmeve dhe kërcënimeve të bëra online, të cilat janë ende në procedurë prokuroriale.

INDIKATORI 3.4

— HETIMET PËR TË GJITHA LLOJET E SULMEVE DHE DHUNËS NDAJ GAZETARËVE DHE AKTORËVE TJERË TË MEDIAVE ZHVILLOHEN NË MËNYRË TRANSPARENTE

Rezultati për vitin 2022: 3.09 / Rezultati për vitin 2023: 3.10

Situata sa i përket transparencës së proceseve gjyqësore në të cilat palët janë gazetarë është pothuajse e njëjtë me një vit më parë. Gjykatat Themelore Civile dhe Penale në Shkup nuk japin informacion të detajuar për procedurat gjyqësore për sulmet ndaj gazetarëve. Gjykatat nuk kanë praktikë të informimit të publikut për procedurat që kanë të bëjnë me sulmet ndaj gazetarëve dhe mediave. Sistemi ekzistues i bazës së informacionit nuk ofron mundësi për një kërkim të saktë të proceseve të kaluara dhe aktuale në të cilat gazetarët paraqiten si palë.

INDIKATORI 3.5


— NGA ORGANET SHKETËRORE JANË VENDOSUR SISTEMET PËR GRUMBULLIMIN E TË DHËNAVE STATISTIKORE CILËSORE PËR PARANDALIMIN E MOSNDËSHKIMIT

Rezultati për vitin 2022: 3.41 / Rezultati për vitin 2023: 3.40

Situata pothuajse nuk ka ndryshuar në krahasim me vitet e mëparshme për sa i përket këtij treguesi. Gjykatat dhe institucionet kompetente, përkundër iniciativave të SHGM-së, ende nuk kanë krijuar sisteme cilësore statistikore, në bazë të të cilave mund të japin të dhëna të sakta për të gjitha proceset gjyqësore në të cilat palë janë gazetarët apo mediat. As gjykata civile dhe as ajo penale në Shkup nuk janë në gjendje të japin informacion të detajuar në lidhje me rastet në të cilat gazetarët paraqiten si palë në procedurë.

IV

Siguria reale



INDIKATORI 4.1

— KËRCËNIMET DHE NGACMIMET QË NUK KANË TË BËJNË ME SIGURINË FIZIKE

Rezultati për vitin 2022: 3.87 / Rezultati për vitin 2023: 3.80

Edhe pse në vitin 2022 ka pasur një përmirësim të lehtë për sa i përket numrit të sulmeve nga kjo kategori, shkalla e mosndëshkimit për këtë lloj sulmesh është ende e lartë në vend dhe për këtë arsye ka një kthim të lehtë në vitin 2023. Ndryshe nga viti 2020 dhe 2021, kur SHGM regjistroi shtatë, respektivisht tre sulme të këtij lloji, në vitin 2022 dhe 2023 u regjistruan nga dy sulme ndaj gazetarëve. Megjithatë, nga dymbëdhjetë sulmet që ndodhën në tre vitet e mëparshme duke përfshirë vitin 2020, fatkeqësisht vetëm dy raste janë zgjidhur nga gjykata.

INDIKATORI 4.2

— KËRCËNIMET NDAJ JETËS DHE SIGURISË FIZIKE TË GAZETARËVE

Rezultati për vitin 2022: 3.69 / Rezultati për vitin 2023: 3.67

Në këtë tregues vërehet një përkeqësim i lehtë i situatës, kryesisht për shkak të sanksionimit joefektiv të kërcënimeve të ndodhura në vitet e mëparshme. Në krahasim me vitin 2022, kur SHGM ka regjistruar vetëm dy kërcënime, në vitin 2023 është regjistruar vetëm një kërcënim për jetën dhe sigurinë e gazetarit Ognen Janeski, dhe ky rast është ende në procedurë prokuroriale.

INDIKATORI 4.3

— SULMET E REALTA

Rezultati për vitin 2022: 4.25 / Rezultati për vitin 2023: 4.36

Krahasuar me vitin 2022, kur kishte një praktikë pozitive në zhvillimin e hetimeve dhe veprimeve të autoriteteve gjyqësore, në vitin 2023 janë shënuar dy raste të sulmeve fizike ndaj gazetarëve dhe punonjësve të medias. Në këto raste organet kompetente kanë vepruar relativisht me efikasitet dhe shpejtësi dhe sulmuesit janë dënuar me dënime të plotfuqishme.

INDIKATORI 4.4

— KËRCËNIMET DHE SULMET NDAJ MEDIAVE DHE SHOQATAVE TË GAZETARISË

Rezultati për vitin 2022: 4.53 / Rezultati për vitin 2023: 4.53

SHGM nuk regjistroi asnjë sulm të këtij lloji në vitin 2023. Krahasuar me vitet e mëparshme, vlerësimi për këtë tregues mbetet i pandryshuar.

Titulli origjinal
Maqedonia e Veriut – Treguesit për
shkallën e lirisë së mediave dhe Indeksi
i Sigurisë së Gazetarëve 2023

Botues
Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM)
Shkup, 2024



Autor
Milan Spirovski

Recenzentët e raportit
Marina Tuneva
Ivan Breshkovski

Përkthimi nga gjuha maqedonase
në gjuhën shqipe
Ferikan Iljazi

Fotografia e ballinës
Andrija Vukelić

Dizajni
comma.rs



Ky publikim është prodhuar me mbështetjen
financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja
e tij është përgjegjësi vetëm e autorit
dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht
pikëpamjet e Bashkimit Evropian.